



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.32

25 mars

2009

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Ligj nr.10 082 datë 23.2.2009	Për miratimin e kontratës së koncesionit të formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) për kultivimin e ullirit, në një sipërfaqe deri në 1000 ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevidh dhe Gosë, Kavajë, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si autoritet kontraktues dhe “Agrotal 1” sh.a.-së, Tiranë	1789
Ligj nr.10 084 datë 23.2.2009	Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”	1789
Ligj nr.10 085 datë 26.2.2009	Për ratifikimin e “Marrëveshjes për themelimin e shkollës rajonale të administratës publike (ReSPA)”	1790
Ligj nr.10 086 datë 26.2.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën ndërkombëtare “Për barrët dhe hipotekat detare”	1799
Ligj nr.10 087 datë 26.2.2009	Për disa ndryshime në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar	1805
Ligj nr.10 088 datë 2.3.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në protokollin shtesë të konventës për lehtësitë doganore për turizmin, në lidhje me importimin e dokumenteve e të materialeve publicitare turistike ...	1806
Ligj nr.10 089 datë 2.3.2009	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në konventën për lehtësitë doganore për turizmin	1815
Vendim i KM nr.224, datë 19.2.2009	Për procedurat e krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si pasojë e korrigjimeve, të kryera nga komisioni vendor i vlerësimit të titujve të pronësisë (KV)	1822

LIGJ
Nr.10 082, datë 23.2.2009

PËR MIRATIMIN E KONTRATËS SË KONCESIONIT TË FORMËS “BOT” (NDËRTIM, OPERIM DHE TRANSFERIM) PËR KULTIVIMIN E ULLIRIT, NË NJË SIPËRFAQE DERI NË 1 000 HA, NË KOMUNAT SYNEJ, LUZ I VOGËL, KRYEVIDH DHE GOSË, KAVAJË, NDËRMJET MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT, SI AUTORITET KONTRAKTUES DHE “AGROTAL 1” SHA-SË, TIRANË

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Miratohet kontrata e koncesionit e formës “BOT” (ndërtim, operim dhe transferim) për kultivimin e ullirit, në një sipërfaqe deri në 1 000 (një mijë) ha, në komunat Synej, Luz i Vogël, Kryevidh dhe Gosë, Kavajë, ndërmjet Ministrisë së Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit, si autoritet kontraktues dhe “AGROTAL 1” sha-së, Tiranë.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6089, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ
Nr.10 084, datë 23.2.2009

**PËR DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR.8669,
DATË 26.10.2000 “PËR REGJISTRIMIN E PËRGJITHSHËM
TË POPULLSISË DHE BANESAVE”**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8669, datë 26.10.2000 “Për regjistrimin e përgjithshëm të popullsisë dhe banesave”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Neni 11 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 11

Komisioni Qendror i Regjistrimit kryesohet nga Zëvendëskryeministri. Mënyra e organizimit, funksionimit dhe përbërja e këtij komisioni miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.”.

Neni 2

Në nenin 12 bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

- a) Në shkronjën “ç” dhe kudo në ligj, fjala “prefektura” zëvendësohet me fjalën “qarqe”.
- b) Pas shkronjës “ç” shtohen shkronjat “d”, “dh” dhe “e” me këtë përmbajtje:
“d) i rekomandon Këshillit të Ministrave aktet ligjore dhe nënligjore për kryerjen e regjistrimit;
- dh) ndan detyrat për institucionet e përfshira në procesin e regjistrimit;
- e) miraton kalendarin e veprimtarive të regjistrimit dhe pyetësorin e anketimit.”.

Neni 3

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6091, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ Nr.10 085, datë 26.2.2009

PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES PËR THEMELIMIN E SHKOLLËS RAJONALE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (ReSPA)”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja për themelimin e shkollës rajonale të administratës publike (ReSPA)”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6092, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE THEMELUESE
E SHKOLLËS RAJONALE TË ADMINISTRATËS PUBLIKE (ReSPA)
12 shtator 2008

Preambulë

Republika e Shqipërisë, Bosnja dhe Hercegovina, Republika e Kroacisë, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë, Mali i Zi, Republika e Serbisë dhe Misioni i Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke vepruar në emër të Kosovës, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, (këtu të quajtur “Palët”), në prani të Komisionit European,

duke kujtuar që në qershor 2003 Këshilli i Bashkimit European miratoi “Agjendën e Selanikut për Ballkanin Perëndimor: Lëvizja drejt integritimit european” që inkurajonte krijimin e një mekanizmi rajonal që siguron trajnimin dhe arsimin për administratën publike;

duke kujtuar që “Protokolli i bashkëpunimit mbi krijimin e shkollës rajonale të administratës publike (faza 1)” u nënshkrua më 2 maj 2006 nga përfaqësuesit e Republikës së Shqipërisë, Bosnjë - Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë, Bashkimin Shtetëror të Serbisë dhe Malit të Zi, së bashku me Republikën e Malit të Zi dhe Republikën e Serbisë, Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK), që vepron në emër të Kosovës, në pajtim me Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, në prani të Komisionit European;

duke kujtuar që, në pajtim me nenin V të këtij protokoll, palët shqyrtuan “institucionalizimin e mëtejshëm të bashkëpunimit të tyre, duke përfshirë pjesëmarrjen e të gjithë anëtarëve të ReSPA-s në masat e ngritjes së fondeve”;

duke kujtuar marrëveshjen e arritur në Paris më 31 janar 2008 në sesionin e 6-të të Komitetit Drejtues për të vazhduar me themelimin e një shkolle rajonale të administratës publike (ReSPA) që gjendet në Mal të Zi;

duke kujtuar nënshkrimin e letrës së qëllimit, të nënshkruar në Silloveni më 12 qershor 2008;

duke rënë dakord që ReSPA do të organizohet dhe operojë në pajtim me dispozitat e mëposhtme:

KAPITULLI I
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1
Themelimi

ReSPA themelohet si një organizatë ndërkombëtare.

Neni 2
Zotësia juridike

ReSPA gëzon atë zotësi juridike që mund të jetë e nevojshme për të ushtruar funksionet dhe përmbushjen e objektivave, duke përfshirë zotësinë për të lidhur kontrata, përftuar dhe disponuar mbi pasuri të luajtshme dhe të paluajtshme dhe të fillojë procese gjyqësore.

Neni 3
Selia

1. Selia e ReSPA-s do të jetë në Danilovgrad, Mal i Zi.
2. Ndërmjet ReSPA-s dhe Malit të Zi do të përfundohet një marrëveshje për selinë.

KAPITULLI II OBJEKTIVAT

Neni 4 Objektivat

Objektivat e ReSPA-s, janë:

- përmirësimi i bashkëpunimit në sferën e administratës publike ndërmjet anëtarëve të ReSPA-s;
- fuqizimi i shkëmbimit me shtetet anëtare të Bashkimit Europian dhe zonës ekonomike europiane;
- fuqizimi i kapacitetit administrativ në administratat publike të anëtarëve të ReSPA-s që kërkohen nga procesi i integritetit Europian;
- zhvillimi i burimeve njerëzore në administratat publike të anëtarëve të ReSPA-s, në pajtim me parimet e hapësirës administrative europiane.

KAPITULLI III AKTIVITETET

Neni 5 Aktivitetet

ReSPA ndërmerr aktivitete të ndryshme në pajtim me objektivat e saj, duke përfshirë, ndër të tjera:

a) analizën e nevojave rajonale: ReSPA kryen analizën e nevojave për trajnim në bashkëpunim me anëtarët e saj për të identifikuar ato nevoja trajnimit që mund të ndërmerren me efektivitet në nivel rajonal;

b) trajnimin e punonjësve të shërbimit publik: ReSPA siguron trajnim për grupe të përziera të punonjësve të shërbimit publik nga administratat e anëtarëve, duke përfshirë, nëpërmjet seminareve dhe shkollat verore/dimërore për profesionistët e administratës publike, dhe nëpërmjet zbatimit të trajnimit nëpërmjet skemave të lëvizjes duke u dhënë mundësi punonjësve të shërbimit publik të përftojnë eksperiencën e konteksteve të ndryshme;

c) sistemet e trajnimit: ReSPA vepron për të përmirësuar kuadrin institucional për menaxhimin e trajnimit dhe edukimit të cilësisë për administratën publike të anëtarëve të vet dhe përpiqet të përmirësojë disponibilitetin dhe cilësinë e sistemeve të trajnimit dhe arsimit në anëtarët e ReSPA-s;

d) rrjetet, shkëmbimet dhe komunitetet e praktikës: ReSPA stimulon bashkëpunimin ndërmjet institucioneve të administratës publike të anëtarëve dhe institucioneve të ngjashme të shteteve anëtare të Bashkimit Europian, si dhe pjesëmarrjen në rrjetet ndërkombëtare, dhe lehtëson shkëmbimin e informacionit dhe eksperiencave. ReSPA mban konferenca të rregullta dhe mbështet komunitetet ndërkombëtare të praktikës;

e) burimet e informacionit: ReSPA mbështet shkëmbimin e informacionit nëpërmjet faqeve të internetit, publikimit p.sh. të njoftimeve, krijimit të një biblioteke elektronike dhe nxjerrjen e publikimeve të specializuara;

f) metodologjitë dhe materialet e trajnimit: ReSPA ndihmon zhvillimin e udhëzimeve metodologjike për trajnimin e efektshëm, inkurajon risinë, zhvillimin bashkëpunues të materialeve të trajnimit, fuqizimin e bazës së kërkimit për trajnimin dhe arsimimin e administratës publike.

KAPITULLI IV ANËTARËT, VËZHGUESIT, PJESËMARRËSIT

Neni 6 Anëtarët

Palët në këtë Marrëveshje janë anëtarë të ReSPA-s.

Neni 7
Anëtarët shtesë

1. Vende të tjera kandidate ose kandidate të mundshme për në Bashkimin Europian, të përcaktuara nga Bashkimi Europian, mund të bëjnë kërkesë për të aderuar në këtë Marrëveshje dhe në këtë mënyrë të bëhen anëtarë të ReSPA-së.

2. Rezolutat në lidhje me kërkesat për aderim në Marrëveshje bëhen nga Bordi Qeverisës në pajtim me nenin 11(3) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 8
Vëzhguesit

1. Vende të tjera kandidate ose kandidate të mundshme për në Bashkimin Europian, të përcaktuara nga Bashkimi Europian, mund të kërkojnë të bëhen vëzhguese në ReSPA.

2. Shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose zona ekonomike europiane, që kontribuojnë në masë të konsiderueshme, financiarisht ose ndryshe për ReSPA-n, mund të kërkojnë të bëhen vëzhguese në ReSPA.

3. Vëzhguesit në ReSPA mund të ndjekin mbledhjet dhe marrin plotësisht pjesë në punën e Bordit Qeverisës pa të drejtë vote.

4. Rezolutat në lidhje me kërkesat për t'u bërë vëzhgues në ReSPA bëhen nga Bordi Qeverisës në pajtim me nenin 11(3) të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 9
Pjesëmarrësit

1. Vende të tjera kandidate ose kandidate të mundshme për në Bashkimin Europian, të përcaktuara nga Bashkimi Europian, shtetet anëtare të Bashkimit Europian ose zona ekonomike europiane, shtete ose organizata të tjera, mund të kërkojnë të marrin pjesë në aktivitetet e ReSPA.

2. Rezolutat në lidhje me kërkesat për t'u bërë pjesëmarrës në aktivitetet e ReSPA-s bëhen nga Bordi Qeverisës në pajtim me nenin 11(3) të kësaj Marrëveshjeje.

KAPITULLI V
INFORMACIONI

Neni 10
Aksesi në informacion dhe të dhëna

Anëtarët e ReSPA-s marrin përsipër të sigurojnë akses në informacionin dhe të dhënat e nevojshme për ReSPA-n për të përmbushur punën e saj, në pajtim me legjislacionin e brendshëm.

KAPITULLI VI
AKTET

Neni 11
Rezolutat

1. Bordi Qeverisës miraton rezoluta që do të jenë detyruese.

2. Bordi Qeverisës miraton rezoluta për të gjitha çështjet në lidhje me përgjegjësisë e tij sipas përcaktimit në nenin 15(1), duke përfshirë rregullat procedurale, rregulloren financiare, rregulloren e personelit dhe aderimin e anëtarëve të rinj.

3. Rezolutat të miratohen me unanimitet nga të gjithë anëtarët e ReSPA-s, përveç kur merret vendim për shtyrjen e kësaj Marrëveshjeje, në pajtim me nenin 30.

Neni 12
Vendime të tjera

Bordi Qeverisës mund të miratojë vendime në pajtim me rregullat e veta të procedurës.

**KAPITULLI VII
BORDI QEVERISËS**

Neni 13

Bordi Qeverisës është organi vendimmarrës i ReSPA-s.

Neni 14
Përbërja

1. Bordi Qeverisës përbëhet nga një përfaqësues nga secili anëtar i ReSPA-s. Përfaqësuesit dërgohen nga ministrinë ose institucionet ekuivalente, përgjegjëse për administratën publike, zhvillimin e burimeve njerëzore ose për integrimin evropian.

2. Secili anëtar i ReSPA-s emëron një ministër ose person të barabartë me të, si përfaqësues në Bordin Qeverisës për mbledhjet e tij në nivel ministror.

3. Secili anëtar i ReSPA-s emëron një nëpunës të lartë dhe një zëvendës, si përfaqësues të përhershëm në Bordin Qeverisës për mbledhjet e tij në një nivel të zyrtarëve të lartë.

4. Një përfaqësues i Komisionit Evropian merr pjesë në Bordin Qeverisës kryesisht, pa të drejtë vote.

5. Drejtori i Sekretariatit të ReSPA-s merr pjesë në Bordin Qeverisës kryesisht, pa të drejtë vote.

6. Bordi Qeverisës mund të ftojë shtete dhe organizata të tjera të jenë të pranishëm në mbledhjet e tij dhe të marrin pjesë në diskutime pa të drejtë vote.

7. Bordi Qeverisës mund të ftojë ekspertë për të marrë pjesë në seancat e tij.

Neni 15
Përgjegjësitë

1. Bordi Qeverisës:

a) siguron udhëzimet e politikës së përgjithshme të ReSPA-s, në pajtim me objektivat e ReSPA-s;
b) siguron që aktivitetet e ReSPA-s të kontribuojnë në procesin e integritet evropian;
c) miraton programin vjetor të ReSPA-s për punën dhe buxhetin;
d) pranon dhe vepron mbi raportet, duke përfshirë raportet e auditëve të pavarur;
e) miraton rezoluta mbi kërkesat e vendeve për të aderuar në këtë Marrëveshje në pajtim me nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje;

f) miraton rezoluta mbi kërkesat e vendeve për t'u bërë vëzhguese në ReSPA për një afat dyvjeçar në pajtim me nenin 8 të kësaj Marrëveshjeje, si dhe rezolutat mbi rinovimin e statusit të vëzhguesit;

g) miraton rezolutat mbi kërkesat e vendeve dhe organizatave të tjera për të marrë pjesë në aktivitetet e ReSPA-s në pajtim me nenin 9 të kësaj Marrëveshjeje. ReSPA mund të vendosë tarifë për këtë pjesëmarrje në pajtim me rregulloret financiare;

h) miraton rregulloret financiare të ReSPA-s;

i) cakton një kufi për buxhetin kryesor vjetor;

j) miraton rregullat e procedurës;

k) miraton rregulloren e personelit;

l) emëron dhe shkarkon drejtorin;

m) vendos metodën e zgjedhjes së auditorit(ve) të pavarur për të verifikuar ekzekutimin e rregullt të buxhetit kryesor dhe zbatimin e "fondeve të menaxhuara drejtpërdrejt" të dhëna ReSPA-s, me qëllim që të financojë aktivitetet e saj, duke njohur parimet e INTOSAI-it në lidhje me auditimin e organizatave ndërkombëtare, veçanërisht rolin e institucioneve të auditit të lartë;

n) cakton auditorin(ët) e pavarur;

- o) miraton metodën dhe kriteret për zgjedhjen e trajnerëve dhe ekspertëve;
 - p) miraton Marrëveshjen për selinë;
 - q) miraton propozimet për mendimet e kësaj Marrëveshjeje.
2. Bordi Qeverisës mund të krijojë organe vartësie me mandate specifike dhe t'i delegojë Sekretariatit detyra të tjera që nuk janë specifikuar në këtë Marrëveshje me qëllim që të përmbushen objektivat dhe aktivitetet e ReSPA-s.
3. Bordi Qeverisës i paraqet Bashkimit Europian dhe anëtarëve të ReSPA-s raporte vjetore mbi aktivitetet e ReSPA-s.
4. Bordi Qeverisës përmbush detyra të tjera të nevojshme për arritjen e objektivave të ReSPA-s.

Neni 16 **Funksionimi**

1. Bordi Qeverisës zhvillon takime në nivel ministror dhe zyrtarësh të lartë.
2. Bordi Qeverisës zhvillon mbledhjen e parë brenda dy muajve nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje.
3. Bordi Qeverisës kryesohet, me afat njëvjeçar, nga secili prej anëtarëve të ReSPA-s në radhë sipas një liste në bazë të renditjes së citimit në paragrafin e parë të preambulës.
4. Bordi Qeverisës zhvillon mbledhje të paktën një herë në vit në nivel ministror.
5. Bordi Qeverisës zhvillon mbledhje semestrale në seanca të zakonshme në nivel zyrtarësh të lartë dhe kurdoherë që është e nevojshme në seanca të jashtëzakonshme.

KAPITULLI VIII **Sekretariati**

Neni 17

1. Sekretariati është organi ekzekutiv i ReSPA-s.
2. Sekretariati përbëhet nga drejtori dhe personeli i ReSPA-s.
3. Sekretariati mbështetet nga punonjës teknikë dhe të shërbimit.

Neni 18 **Përgjegjësitë**

1. Sekretariati është përgjegjës për të siguruar funksionimin e duhur të ReSPA-s.
2. Sekretariati është përgjegjës për hartimin dhe paraqitjen e programit vjetor të punës dhe të Buxhetit të Bordi Qeverisës për aprovim, si dhe për zbatimin e tij.
3. Sekretariati i paraqet Bordit Qeverisës raporte mbi funksionimin e ReSPA-s, zbatimin e programit të punës dhe çështje të tjera, që kërkohen nga Bordi Qeverisës.

Neni 19 **Drejtori**

1. Drejtori emërohet për një mandat prej pesë vjetësh, një herë e rinovueshme.
2. Drejtori është kreu i Sekretariatit. Drejtori është përgjegjës për të siguruar funksionimin e rregullt dhe efikas të ReSPA-s në pajtim me rregulloren financiare dhe rregulloren e personelit. Drejtori i raporton dhe përgjigjet para Bordit Qeverisës.
3. Drejtori vjen nga një prej anëtarëve të ReSPA-s.
4. Drejtori ka të drejtë të veprojë në emër të ReSPA-s, duke përfshirë nënshkrimin e marrëveshjes së selisë dhe kontratave të nevojshme për funksionimin e ReSPA-s dhe në pajtim me dispozitat e rregulloreve financiare dhe rezolutave të tjera.
5. Bordi Qeverisës mund të largojë nga detyra drejtorin para përfundimit të mandatit të emërimit të tij/saj për një shkak të arsyeshëm. Një shkak i tillë i arsyeshëm përfshin, pa u kufizuar, shërbime të pakënaqshme dhe sjellje të rëndë, në pajtim me rregulloren e personelit.

Neni 20
Kushtet e punësimit

1. Rekrutimi, përzgjedhja, ngritja në detyrë dhe të gjitha aspektet e menaxhimit të personelit bazohen në merita dhe respektojnë kërkesat e aksesit të barabartë në punësim, drejtësi, transparencë, diversitet dhe përfaqësim nga të gjithë anëtarët e ReSPA-s.

2. Personeli dhe punonjësit teknikë dhe të shërbimit të ReSPA-s përzgjidhen në pajtim me rregulloren e personelit.

Neni 21
Paanësia

1. Drejtori merr udhëzime vetëm nga Bordi Qeverisës.

2. Drejtori dhe personeli i ReSPA-s nuk kërkojnë, pranojnë ose veprojnë sipas udhëzimeve nga një anëtar individual i Bordit Qeverisës ose nga një palë e tretë.

KAPITULLI IX
MENAXHIMI FINANCIAR

Neni 22
Financimi

ReSPA financohet nga kontributet dhe dhurimet e anëtarëve.

Neni 23
Buxheti kryesor

1. Përbajtja e buxhetit kryesor përcaktohet në rregulloret financiare. Bordi Qeverisës vendos mbi buxhetin vjetor kryesor të ReSPA-s në pajtim me rregulloret financiare.

2. Buxheti kryesor financohet nga buxhetet e anëtarëve të ReSPA-s, ku secili prej tyre kontribuon me një pjesë të barabartë.

3. Limiti për buxhetin kryesor vjetor për secilin anëtar të ReSPA-s caktohet në 120 000 euro për vitin 2009 dhe 150 000 euro për vitin 2010.

4. Një palë që aderohet në këtë Marrëveshje sipas procedurës së nenit 7 është e detyruar të paguajë pjesën e saj të plotë të buxhetit kryesor për të gjithë vitin e aderimit të saj.

5.) Anëtarët e ReSPA-s e japin kontributin e tyre gjatë tri muajve të parë të vitit buxhetor të ReSPA-s, sipas përcaktimit në rregulloret financiare të ReSPA-s. Për vitin 2009 kontributet jepen brenda një muaji nga hyrja në fuqi e kësaj Marrëveshjeje në pajtim me nenin 27, paragrafët 2 dhe 3.

6. Kontributet në natyrë për ReSPA-n, duke përfshirë atë të vendit pritës, nuk konsiderohen si pjesë e kontributit të buxhetit kryesor të anëtarëve të ReSPA-s.

7. ReSPA nuk lejohet të marrë borxhe, përveç për qëllime operative të qarkullimit të parave, përveç kur vendoset me unanimitet nga Bordi Qeverisës.

8. Shpenzimet e auditorit(ëve) të pavarur financohen nga buxheti kryesor i ReSPA-s.

Neni 24
Financimi i aktiviteteve të ReSPA-s

1. Aktivitetet e ReSPA-s, siç përshkruhen në nenin 5, mund të financohen nga dhurimet e anëtarëve të ReSPA-s, vëzhguesve dhe donatorëve të tjerë ose nga buxheti kryesor, në pajtim me rregulloret financiare.

2. Aktivitetet e financuara nga dhurimet mund të menaxhohen nga financuesit ose kontraktorët e tyre. Po ashtu, ato mund t'i jepen ReSPA-s dhe të menaxhohen drejtpërdrejt nga Sekretariati, nën përgjegjësinë e ReSPA-s (fonde të menaxhuara drejtpërdrejt). ReSPA lejohet të vendosë tarifa mbi “fondet e menaxhuara drejtpërdrejt”, në pajtim me rregulloret financiare.

Neni 25
Raportimi financiar

1. Sekretariati përgatit raporte vjetore për ekzekutimin e buxhetit kryesor, në pajtim me rregulloret financiare.
2. Sekretariati përgatit raporte mbi përdorimin e “fondeve të menaxhuara drejtpërdrejt”, sipas përcaktimit në rregulloret financiare të ReSPA-s.
3. Sekretariati mund të përgatisë gjithashtu raporte mbi përdorimin e “fondeve të menaxhuara drejtpërdrejt” në pajtim me kërkesat e përgjegjshmërisë të financuesit.
4. Kryhet një auditim i pavarur vjetor nga auditori(ët) e pavarur mbi përdorimin e buxhetit kryesor dhe për “fondet e menaxhuara drejtpërdrejt”, të marra nga anëtarët e ReSPA-s, vëzhguesit ose donatorë të tjerë. Rezultatet përfundimtare të auditimit, pas një procesi të drejtë dhe me komente nga ReSPA, bëhen publike.
5. Raportet e përmendura në paragrafët 1, 2 dhe 3 të këtij neni i nënshtrohen auditimit nga auditori(ët) e pavarur.

**KAPITULLI X
PRIVILEGJET DHE IMUNITETET**

Neni 26

ReSPA, drejtori dhe personeli i ReSPA-s gëzojnë, në secilin prej anëtarëve të ReSPA-s, privilegjet dhe imunitetet që janë të nevojshme për ushtrimin e pavarur të funksioneve të tyre, të barasvlershme me seksionet e zbatueshme të Konventës mbi privilegjet dhe imunitetet të Kombeve të Bashkuara të vitit 1946. Veçanërisht:

- a) ReSPA gëzon privilegjet dhe imunitetet e barasvlershme me ato të nenit II të Konventës;
- b) Drejtori dhe personeli kanë privilegje dhe imunitete të barasvlershme me ato të nenit V, seksioni 18 i Konventës;
- c) Drejtori ka privilegje dhe imunitete shtesë të barasvlershme me ato të seksionit 19 të Konventës;
- d) Bordi Qeverisës merr në shqyrtim heqjen dorë nga imuniteti dhe bashkëpunon me anëtarët dhe merr masa për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve në një mënyrë që është e barasvlershme me seksionet 20, 21 dhe 29 të Konventës.

**KAPITULLI XI
DISPOZITAT E FUNDIT**

Neni 27

Ratifikimi dhe hyrja në fuqi

1. Kjo Marrëveshje ratifikohet, pranohet ose aprovohet nga palët në pajtim me kërkesat e tyre ligjore përkatëse.
2. Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën pesë nga shtatë palët, duke përfshirë Malin e Zi, kanë depozituar instrumentet e tyre të ratifikimit, pranimit ose aprovimit te depozituesi.
3. Për palët që ratifikojnë, pranojnë ose aprovojnë Marrëveshjen pas depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit, pranimit ose aprovimit, Marrëveshja hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas datës në të cilën pala depoziton instrumentet e saj të ratifikimit, pranimit ose aprovimit tek depozituesi.
4. Në datën e hyrjes në fuqi të kësaj Marrëveshjeje, “Protokolli i bashkëpunimit mbi krijimin e shkollës rajonale të administratës publike” do të pushojë së qeni në fuqi.

Neni 28

Aderimi

Pasi Bordi Qeverisës të ketë miratuar rezolutën mbi aplikimin e një vendi për të aderuar në këtë Marrëveshje në pajtim me nenin 7, aderimi hyn në fuqi në ditën e parë të muajit pas depozitimit të instrumentit të ratifikimit, pranimit ose aprovimit te depozituesi.

Neni 29
Amendimet

1. Kjo Marrëveshje mund të ndryshohet me propozim të një anëtari të ReSPA-s.
2. Çdo propozim për të ndryshuar këtë Marrëveshje u komunikohet nga Sekretariati anëtarëve të ReSPA-s të paktën dy muaj para paraqitjes për shqyrtim dhe aprovim në Bordin Qeverisë.
3. Amendimet në këtë Marrëveshje të aprovuar në pajtim me paragrafin 2 i nënshtrohen ratifikimit, pranimit ose aprovimit nga anëtarët e ReSPA-s, në pajtim me kërkesat e tyre përkatëse ligjore.

Neni 30
Kohëzgjatja

1. Kjo Marrëveshje mbetet në fuqi për shtatë vjet pas datës së hyrjes së saj në fuqi, me mundësinë e zgjatjes së saj me marrëveshje ndërmjet anëtarëve të ReSPA-s.
2. Para mbarimit të vitit të 5-të pas datës së hyrjes së saj në fuqi, anëtarët e ReSPA-s vendosin, me një shumicë prej 2/3 të të gjithë anëtarëve të ReSPA-s, nëse do të shtyhet Marrëveshja.

Neni 31
Tërheqja

1. Një anëtar i ReSPA-s mund të tërhiqet nga kjo Marrëveshje me anë të njoftimit me shkrim të tërheqjes drejtuar depozituesit. Ky njoftim hyn në fuqi jo më parë se përfundimi i vitit financiar të ReSPA-s pas vitit financiar në të cilën njoftimi është marrë nga depozituesi.
2. Një anëtar i ReSPA-s nuk mund të lirohet, për shkak të tërheqjes së tij, nga detyrimet financiare që janë mbledhur kur ai ishte anëtar i kësaj Marrëveshjeje.

Neni 32
Depozituesi

Qeveria e Malit të Zi është depozituesi i kësaj Marrëveshjeje.

Në dëshmi të kësaj, të poshtëshënuarit, duke qenë rregullisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Marrëveshje.

Bërë në _____, më _____, në një kopje të vetme autentike në gjuhën angleze

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Bosnjës dhe Hercegovinës
Për Qeverinë e Republikës së Kroacisë
Për Qeverinë e ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë
Për Qeverinë e Malit të Zi
Për Qeverinë e Republikës së Serbisë

Për Misionin e Administratës së Përkohshme të Kombeve të Bashkuara në Kosovë, duke vepruar në emër të Kosovës, në pajtim me rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244

LIGJ
Nr.10 086, datë 26.2.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN NDËRKOMBËTARE
“PËR BARRËT DHE HIPOTEKAT DETARE”

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën ndërkombëtare “Për barrët dhe hipotekat detare”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

Shpallur me dekretin nr.6093, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi

KONVENTA NDËRKOMBËTARE
MBI BARRËT DHE GARANCITË HIPOTEKORE DETARE
(Gjenevë, 6 maj 1993)

Shtetet palë në këtë Konventë,
të vetëdijshme mbi nevojën për të përmirësuar kushtet e financimit të anijeve dhe zhvillimit të flotave kombëtare tregtare.

duke pranuar dëshirën për uniformitet ndërkombëtar në fushën e barrëve dhe garancive hipotekore detare dhe si pasojë;

të bindur mbi domosdoshmërinë për një instrument ligjor ndërkombëtar që do të drejtojë garancitë hipotekore dhe barrët detare;

kanë vendosur të lidhin një Konventë për këtë qëllim dhe për rrjedhojë kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Njohja dha zbatimi i garancive hipotekore, “hipotekave” dhe detyrimeve

Garancitë hipotekare, “Hipotekat” dhe detyrimet e regjistrueshme të një natyre të njëjtë, të cilat detyrime të regjistrueshme të së njëjtës natyrë do të referohen më poshtë si “detyrime” të aplikueshme për mjetet lundruese detare, njihen dhe zbatohen në shtetet palë, me kusht që:

a) Garancitë hipotekare, “hipotekat” dhe detyrimet në fjalë të jenë realizuar dhe regjistruar në përputhje me ligjin e shtetit në të cilin mjete lundrues është i regjistruar;

b) Regjistri dhe çdo instrument që kërkohet të depozitohet pranë regjistruesit në përputhje me ligjin e shtetit në të cilin mjete lundrues është regjistruar të jenë të hapura për inspektim publik dhe se fragmente nga regjistri dhe kopje të instrumenteve në fjalë të jenë të disponueshme prej regjistruesit;

c) ose regjistri ose çdo instrument i referuar në nënparagrafin (b) të specifikojë të paktën emrin dhe adresën e personit, në favor të të cilit është realizuar garancia hipotekore, “hipoteka” apo detyrimi ose shuma maksimale e siguruar t’i jetë lëshuar mbajtësit, nëse një gjë e tillë kërkohet nga ligji i shtetit të regjistrimit apo nëse shuma në fjalë specifkohet në instrumentin që krijon garancinë hipotekore,

“hipotekën” ose detyrimin dhe datën dhe të dhëna të tjera të cilat, sipas ligjit të shtetit të regjistrimit, përcaktojnë renditjen në lidhje me garancitë hipotekore, “hipotekat” dhe detyrimet e tjera të regjistruara.

Neni 2

Renditja e garancive hipotekare, “hipotekave” dhe detyrimeve

Niveli i garancive hipotekore të regjistruara, “hipotekave” apo detyrimeve siç është vendosur ndërmjet tyre dhe pa cenuar dispozitat e kësaj Konvente, efekti i tyre për sa i përket palëve të treta përcaktohet nga ligji i shtetit të regjistrimit; megjithatë, pa cenuar dispozitat e kësaj Konvente, të gjitha çështjet, lidhur me procedurën e zbatimit, rregullohen nga ligji i shtetit ku ndodh zbatimi.

Neni 3

Ndryshimi i pronësisë ose regjistrimit

1. Me përjashtim të rasteve të parashikuara nga nenet 11 dhe 12, në të gjitha rastet e tjera që shkaktojnë çregjistrimin e mjetit lundrues nga regjistri i një shteti palë, një shtet palë i tillë nuk duhet të lejojë pronarin të çregjistrojë mjetin lundrues pa fshirë më parë të gjitha garancitë hipotekore, “hipotekat” ose detyrimet, ose pa siguruar pëlqimin me shkrim të të gjithë zotëruesve të garancive hipotekore, “hipotekave” ose detyrimeve të tilla. Megjithatë, atje ku çregjistrimi i mjetit lundrues është i detyrueshëm në përputhje me ligjin e shtetit palë, në rastet kur nuk është rezultat i një shitje të vullnetshme, zotëruesit e garancive hipotekore, “hipotekave” ose detyrimeve të regjistruara njoftohen mbi çregjistrimin në fjalë me qëllim që t’u japin mundësi zotëruesve të tillë të ndërmarrin masat e duhura për të mbrojtur interesat e tyre, përveçse kur zotëruesit bien dakord, çregjistrimi nuk duhet të bëhet më herët se skadimi i një periudhe të arsyeshme kohore, e cila nuk duhet të jetë më e pakët se tre muaj mbas njoftimit përkatës të zotëruesve në fjalë.

2. Pa cenuar nenin 12, paragrafi 5, një anije, e cila është regjistruar në një shtet palë, nuk është e pranueshme për t’u regjistruar në një shtet palë tjetër, përveçse kur:

a) të jetë lëshuar një certifikatë prej shtetit të mëparshëm me efektin që anija është çregjistruar; ose

b) të jetë lëshuar një certifikatë prej shtetit të mëparshëm me efektin që mjeti lundrues do të çregjistrohet menjëherë kur regjistrimi i ri të jetë realizuar. Data e çregjistrimit duhet të jetë data e regjistrimit të ri të mjetit lundrues.

Neni 4

Barrët detare

1. Secila nga pretendimet e mëposhtme ndaj pronarit, çerteruesit demise/bareboat, menaxherit apo operatorit të mjetit lundrues sigurohen nga barrët detare mbi mjetin lundrues:

a) Pretendime për rroga dhe shuma të tjera kundrejt kapitenit, oficerëve dhe anëtarëve të tjerë të mjetit lundrues për sa i përket punësimit të tyre përfshirë kostot e riatdhesimit dhe kontributet e sigurimeve shoqërore që paguhen në emër të tyre;

b) Pretendime për sa i përket humbjes së jetës ose dëmtimeve personale që ndodhin, në tokë apo në det, dhe kanë lidhje direkte me operimin e mjetit lundrues;

c) Pretendime për shpërblime për shpëtimin e mjetit lundrues;

d) Pretendime për tarifën portuale, kanalet dhe rrugët e tjera ujore dhe tarifën e pilotimit;

e) Pretendime bazuar në dëme jokontraktuale që lindin nga humbja fizike ose dëmtimi që shkaktohet nga operimi i mjetit lundrues, përveç humbjes apo dëmtimit të ngarkesës, kontenierëve dhe sendeve të pasagjerëve të cilët transportohen me mjet lundrues.

2. Asnjë barrë detare nuk i ngarkohet mjetit lundrues për të siguruar pretendime të përcaktuara në nënparagrafët (b) dhe (e) të paragrafit 1 të cilat lindin si rezultat i:

a) Dëmtimit në lidhje me transportimin me rrugë detare të naftës apo substancave të tjera të rrezikshme ose të dëmshme për të cilat kompensimi është i pagueshëm ndaj pretenduesit në bazë të konventave ndërkombëtare ose ligjit kombëtar, të cilat parashikojnë përgjegjësi absolute dhe siguracion të detyrueshëm ose mënyra të tjera për të siguruar pretendimet; ose

b) vetive radioaktive ose një kombinimi të vetive radioaktive me veti toksike, eksplozive dhe substanca të tjera të rrezikshme të lëndëve djegëse bërthamore ose të produkteve apo mbetjeve radioaktive.

Neni 5

Prioriteti i barrëve detare

1. Barrët detare, të përcaktuara në neni 4, kanë prioritet ndaj garancive hipotekore, “hipotekave” dhe detyrimeve të regjistruara dhe asnjë pretendim tjetër nuk ka prioritet kundrejt barrëve detare të tilla ose garancive hipotekore, “hipotekave” dhe detyrimeve, të cilat pajtohen me kërkesat e nenit 1, përveçse kur parashikohet në paragrafët 3 dhe 4 të nenit 12.

2. Barrët detare, të përcaktuara në neni 4, renditen sipas rendit që listohen (në atë nen), duke siguruar sidoqoftë që barrët detare, të cilat sigurojnë pretendime për shpërblime për shpëtimin e mjetit lundrues, do të kenë prioritet ndaj të gjitha barrëve detare, të cilat i janë ngarkuar mjetit lundrues para kohës së realizimit të operacioneve që çuan në lindjen e barrëve në fjalë.

3. Barrët detare, të përcaktuara në secilin prej nënparagrafëve a, b, d, dhe e të paragrafit 1 të nenit 4, klasifikohen *pari passu* ashtu siç klasifikohen ndërmjet tyre.

4. Barrat detare që sigurojnë pretendime për shpëtimin e mjetit lundrues, renditen në bazë të rendit të kundërt të kohës kur ndodhën pretendimet e siguruar në këtë mënyrë. Pretendime të tilla çmohen të kenë ndodhur në datën në të cilën secilit operacion shpëtimi iu dha fund.

Neni 6

Barrë të tjera detare

Secili shtet palë mund, sipas ligjit të tij, të akordojë barrë të tjera detare mbi mjetin lundrues për të siguruar pretendime, të ndryshme nga ato të referuara në nenin 4 kundrejt pronarit, çarteruesit demise/bareboat, menaxherit apo operatorit të mjetit lundrues, me kusht që barrë të tilla:

a) T’u nënshtrohen dispozitave të neneve 8, 10 dhe 12;

b) Të shuhet

i) pas një periudhe 6-mujore nga koha kur u lindën pretendimet e siguruar në këtë mënyrë, përveçse kur para skadimit të një periudhe të tillë mjeti lundrues të jetë arrestuar ose sekuestruar, gjë e cila çon në shitje të detyrueshme; ose

ii) në fund të një periudhe 60-ditore mbas shitjes së mjetit lundrues një blerësi *bona fide* (në mirëbesim), periudha në fjalë të fillojë në datën në të cilën shitja të jetë regjistruar në përputhje me ligjin e shtetit në të cilën anija është regjistruar mbas shitjes:

cilado qoftë periudha që përfundon më parë; dhe

c) do të renditen pas barrëve detare, të përcaktuara në nenin 4, dhe gjithashtu pas garancive hipotekore, “hipotekave” ose detyrimeve të regjistruara, të cilat pajtohen me dispozitat e nenit 1.

Neni 7

Të drejtat e mbajtjes/prezervimit

1. Secili shtet palë mund të akordojë sipas ligjit të tij të drejtën e ruajtjes për sa i përket një mjeti lundrues në zotërimin ose të:

a) Një ndërtuesi mjetesh lundruese për të siguruar pretendimin për ndërtimin e saj; ose

b) Një riparuesi mjetesh lundruese për të siguruar pretendimin për riparim, përfshirë rikonstrukcionin e mjetit lundrues të realizuar gjatë një zotërimi të tillë.

2. Këto të drejta mbajtjeje/prezervimi shuhet kur mjeti lundrues pushon së qeni në zotërim të ndërtuesit ose riparuesit të saj, përveçse kur ndodh si pasojë e një arrestimi ose sekuestrimi.

Neni 8

Karakteristikat e barrëve detare

Në varësi të dispozitave të nenit 12, barrët detare ndjekin mjetin lundrues, pavarësisht nga ndryshimet e pronësisë, regjistrimit apo flamurit.

Neni 9

Zhdukja e barrëve detare me kalimin e kohës

1. Barrët detare, të përcaktuara në nenin 4, shuhen mbas një periudhe 1-vjeçare, përveçse kur para mbarimit të një periudhe të tillë, mjeti lundruar është arrestuar ose sekuestruar, gjë e cila çon në një shitje të detyrueshme.

2. Periudha njëvjeçare, referuar në paragrafin 1, fillon:

a) përsa i përket barrës detar, të përcaktuar në nenin 4, paragrafi 1 (a), me pushimin/largimin e pretenduesit nga mjeti lundruar;

b) përsa u përket sigurimeve detare, të përcaktuara në nenin 4, nga paragrafi 1 (b) deri në (e), kur dalin/ realizohen pretendimet e siguruar në këtë mënyrë,

dhe nuk i nënshtrohen pezullimit apo ndërprerjes, duke siguruar megjithatë që koha nuk do të llogaritet gjatë periudhës kur arrestimi i mjetit lundruar nuk lejohet me ligj.

Neni 10

Transferimi dhe zëvendësimi i së drejtës

Transferimi i një pretendimi apo zëvendësimi me një pretendim të siguruar nga një barrë detare nënkupton transferimin ose zëvendësimin e njëkohshëm të barrës detare në fjalë.

Kërkuesit që zotërojnë barrë detare mund të mos zëvendësohen për një kompensim të pagueshëm pronarit të mjetit lundruar në bazë të një kontrate sigurimi.

Neni 11

Njoftimi i shitjes së detyruar

1. Para shitjes së detyruar të një mjeti lundruar në një shtet palë, autoriteti kompetent në një shtet të tillë siguron që të njoftohen në përputhje me këtë nen:

a) Autoriteti përgjegjës për regjistrin në shtetin e regjistrimit;

b) Të gjithë zotëruesit e garancive hipotekore, “hipotekave”, apo detyrimeve të regjistruara, të cilat nuk i janë lëshuar mbajtësit;

c) Të gjithë zotëruesit e garancive hipotekore “hipotekave” ose detyrimeve të lëshuara mbajtësve dhe të gjithë zotëruesit e barrëve detare, të përcaktuara në nenin 4, me kusht që autoriteti kompetent që kryen shitjen e detyruar të marrë njoftim mbi pretendimet e tyre përkatëse; dhe

d) Pronari i regjistruar i anijes.

2. Një njoftim i tillë sigurohet të paktën 30 ditë para shitjes së detyruar dhe duhet të përmbajë ose:

a) Kohën dhe vendin e shitjes së detyruar dhe të dhëna të tilla lidhur me shitjen e detyruar ose procedurat që çuan në një shitje të tillë, ndërsa autoriteti në shtetin palë që drejton procedurat, përcakton nëse është e mjaftueshme mbrojtja e interesave të personave të cilët gëzojnë të drejtën e njoftimit; ose

b) Nëse koha dhe vendi i shitjes së detyruar nuk mund të përcaktohet me siguri, koha e përafërt dhe vendi i parashikuar i një shitjeje të tillë dhe të dhëna të tilla në lidhje me shitjen e detyruar, ndërsa autoriteti në shtetin palë që drejton procedurat përcakton nëse është e mjaftueshme mbrojtja e interesave të personave të cilët gëzojnë të drejtën e njoftimit.

Nëse njoftimi sigurohet në përputhje me nënparagrafin (b), njoftimi shtesë i vendit dhe kohës aktuale të shitjes së detyruar jepet kur ato dihen por, në çdo rast jo më pak se shtatë ditë para shitjes së detyruar.

3. Njoftimi i specifikuar në paragrafin 2 të këtij neni u nis personave të interesuar, nëse njihen, sipas specifikimeve të nenit 1, me shkrim ose niset me postë rekomande ose në mënyrë elektronike apo në mënyra të tjera të përshtatshme, të cilat sigurojnë konfirmimin e marrjes. Për më tepër, njoftimi jepet me anë të njoftimit në shtyp në shtetin ku është realizuar shitja e detyruar dhe, nëse gjykohet e përshtatshme nga ana e autoritetit që drejton një shitje të tillë, në publikime të tjera.

Neni 12

Efektet e shitjes së detyruar

1. Në rastin e shitjes së detyruar në një shtet palë, të gjitha garancitë hipotekore, “hipotekat” ose detyrimet e regjistruara, me përjashtim të atyre të marra përsipër nga ana e blerësit me pëlqimin e zotëruesve, dhe të gjitha barrët detare dhe barrë të tjera të çfarëdo lloji natyre, pushojnë së detyruari mjetin lundruar, me kusht që:

a) Në kohën e shitjes, mjeti lundruar të jetë në zonën e juridiksionit të këtij shteti; dhe

b) Shitja të jetë realizuar në përputhje me ligjin e shtetit në fjalë dhe dispozitat e nenit 11 dhe këtij neni.

2. Kostot dhe shpenzimet që lindin për pasojë të arrestit apo sekuestrimit dhe shitjes në vijim të mjetit lundruar paguhet të parat nga të ardhurat e shitjes. Kosto dhe shpenzime të tilla përfshijnë, ndër të tjera, kostot për mirëmbajtjen e mjetit lundruar dhe ekuipazhit si dhe rrogat, shuma dhe kosto të tjera të referuara në nenin 4, paragrafi 1”a”, të shkaktuara që nga koha e arrestit apo sekuestrimit. Bilanci i të ardhurave shpërndahet në përputhje me dispozitat e kësaj Konvente në shtrirjen e nevojshme për të plotësuar pretendimet përkatëse. Pas plotësimit të të gjitha pretendimeve, pjesa e mbetur e të ardhurave, nëse ka, i paguhet pronarit dhe është lirisht e transferueshme.

3. Një shtet mund të parashikojë në ligjin e tij se, në rastin e shitjes së detyruar të një mjeti lundruar të fundosur apo të ngecur në cektinë pas zhvendosjes së tij nga ana e një autoriteti publik për interes të lundrimit të sigurt apo mbrojtjes së mjedisit detar, shpenzimet e një zhvendosjeje të tillë të paguhet nga të ardhurat e shitjes para të gjitha pretendimeve të tjera të siguruar nga barrë detare mbi mjetin lundruar.

4. Nëse në kohën e shitjes së detyrueshme, mjeti lundruar është në zotërim nga një ndërtues mjetesh lundruese apo riparues mjetesh lundruese, të cilët sipas ligjit në shtetin palë ku ndodh shitja, gëzojnë të drejtën e mbajtjes, ndërtuesi dhe riparuesi në fjalë duhet t’i dorëzojnë zotërimin e mjetit lundruar blerësit, por gëzojnë të drejtën e plotësimit të pretendimit të tyre nga të ardhurat e shitjes, pasi të jenë plotësuar pretendimet e zotëruesve të barrëve detare, të përmendura në nenin 4.

5. Kur një mjet lundruar i regjistruar në një shtet palë ka qenë objekt i një shitjeje të detyruar në secilin shtet palë, autoriteti kompetent me kërkesë të blerësit, lëshon një certifikatë për të shpjeguar se mjeti lundruar është shitur pa asnjë garanci hipotekore, “hipotekave” apo detyrimeve të regjistruara, përveç atyre të pretenduara nga ana e blerësit dhe të gjitha barrëve detare dhe barrëve të tjera, me kusht që të pajtohen kërkesat e përcaktuara në paragrafin 1 (a) dhe (b). Me lëshimin e një certifikate të tillë, regjistruesi është i detyruar të fshijë të gjitha garancitë hipotekare, “hipotekat” apo detyrimet e regjistruara, përveç atyre të pretenduara nga ana e blerësit dhe të regjistrojë mjetin lundruar në emrin e blerësit ose të lëshojë një certifikatë çregjistrimi për qëllim të një regjistrimi, sipas rastit.

6. Shtetet palë sigurojnë se çdo e ardhur nga shitja e detyruar të vihet në dispozicion dhe të transferohet lirshëm.

Neni 13

Fusha e zbatimit

1. Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Konventë, dispozitat e saj zbatohen për të gjitha mjetet lundruese të regjistruara në një shtet palë ose në një shtet, i cili nuk është shtet palë me kushtet që mjetet e lundrimit të këtij të fundit t’i nënshtrohen juridiksionit të shtetit palë.

2. Asgjë në këtë Konventë nuk krijon apo mundëson krijimin e ndonjë të drejte për t’u zbatuar ndaj ndonjë anije në zotërim apo operim nga ana e një shteti dhe përdorur vetëm për shërbime qeveritare jokomerciale.

Neni 14

Komunikimi ndërmjet shteteve palë

Për qëllim të neneve 3, 11 dhe 12 autoritetet kompetente të shteteve palë autorizohen të shkëmbejnë korrespondencë drejtpërdrejt ndërmjet tyre.

Neni 15

Konflikti i konventave

Asnjë dispozitë e kësaj Konvente nuk ndikon mbi aplikimin e ndonjë konvente ndërkombëtare që parashikon kufizim të përgjegjësisë apo aplikim të legjislacionit kombëtar që zbaton këto konventa.

Neni 16

Ndryshimi i përkohshëm i flamurit

Nëse një mjet lundrues i regjistruar në një shtet lejohet të mbajë përkohësisht flamurin e një shteti tjetër, procedohet si më poshtë:

a) Për qëllim të këtij neni, referimet në këtë Konventë ndaj “shtetit në të cilin mjeti lundrues është i regjistruar” ose “shtetit të regjistrimit” çmohet si referime kundrejt shtetit në të cilin mjeti lundrues ishte i regjistruar menjëherë para ndryshimit të flamurit dhe referimi kundrejt “autoritetit përgjegjës për regjistrimin” çmohet të jetë referim kundrejt autoritetit përgjegjës për regjistrimin në atë shtet.

b) Ligji i shtetit të regjistrimit mbetet përcaktues për qëllim të njohjes së garancive hipotekore “hipotekave” apo detyrimeve të regjistruara.

c) Shteti i regjistrimit kërkon një referencë të hollësishme hyrje në regjistrin e tij, ku të specifikohet shteti, flamurin e të cilit mjeti lundrues është lejuar të mbajë përkohësisht; në të njëjtën mënyrë shteti, flamurin e të cilit mjeti lundrues është lejuar të mbajë përkohësisht, kërkon që autoriteti përgjegjës për regjistrimin e mjetit lundrues të specifikojë me anë të një reference të hollësishme në regjistrin e shtetit të regjistrimit.

d) Asnjë shtet palë nuk duhet të lejojë një mjet lundrues të regjistruar në shtetin në fjalë të përdorë përkohësisht flamurin e një shteti tjetër përveçse kur të gjitha garancitë hipotekore, “hipotekat” apo detyrimet e regjistruara mbi mjetin lundrues në fjalë të jenë plotësuar më parë ose kur është dhënë pëlqimi me shkrim i zotëruesve të të gjitha garancive hipotekore, “hipotekave”, apo detyrimeve.

e) Njoftimi i referuar në nenin 11, i jepet gjithashtu autoritetit kompetent përgjegjës për regjistrimin e mjetit lundrues në shtetin, flamurin e të cilit mjeti lundrues lejohet të përdorë përkohësisht.

f) Me lëshimin e certifikatës së çregjistrimit të referuar në nenin 12, paragrafi 5, autoriteti kompetent, përgjegjës për regjistrimin e mjetit lundrues në shtetin, flamuri i të cilit është lejuar të përdoret përkohësisht, me kërkesë të blerësit, lëshon një certifikatë për të shpjeguar se e drejta për të mbajtur flamurin e shtetit në fjalë është shfuqizuar.

g) Asgjë në këtë Konventë nuk duhet të kuptohet si ngarkim i ndonjë detyrimi mbi shtetet palë për të lejuar mjetet e huaja lundruese të mbajnë përkohësisht flamurin e tyre ose për të lejuar mjetet kombëtare lundruese të mbajnë përkohësisht një flamur të huaj.

Neni 17

Depozitari

Kjo Konventë i depozitohet Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 18

Nënshkrimi, ratifikimi, pranimi, miratimi dhe hyrja

1. Kjo Konventë është e hapur për nënshkrim nga çdo shtet në selinë e Kombeve të Bashkuara. Nju Jork, nga 1 shtatori 1993 deri më 31 gusht 1994 dhe pas kësaj mbetet e hapur për hyrje.

2. Shtetet mund të shprehin pëlqimin e tyre për t'u detyruar nga kjo Konventë me anë të:

a) Nënshkrimit pa rezerva lidhur me ratifikimin, pranimin ose aprovimin; ose

b) nënshkrimit që do t'i nënshtrohet ratifikimit, pranimit ose miratimit, pasuar nga ratifikimi, pranimi ose miratimi; ose

c) aderimit.

3. Ratifikimi, pranimi, miratimi ose aderimi realizohen me anë të depozitimit pranë depozituesit të një instrumenti për këtë qëllim.

Neni 19
Hyrja në fuqi

1. Kjo Konventë hyn në fuqi 6 muaj nga data në të cilën 10 shtete të kenë shprehur pëlqimin e tyre për t'u lidhur prej saj.

2. Pëlqimi i një shteti për t'u lidhur nga kjo Konventë pasi të ketë plotësuar kushtet e hyrjes në fuqi të saj, bëhet i efektshëm 3 muaj nga data e shprehjes së tij.

Neni 20
Rishikimi dhe amendimi

1. Konferenca e shteteve palë me qëllim rishikimin ose amendimin e kësaj Konvente thirret nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara me kërkesë të një të tretës së shteteve palë.

2. Çdo pëlqim për t'u lidhur nga kjo Konventë, i shprehur mbas datës së hyrjes në fuqi të një ndryshimi të kësaj Konvente, gjykohet të zbatohet për Konventën e ndryshuar.

Neni 21
Denoncimi

1. Kjo Konventë mund të denoncohet nga një shtet palë në çdo kohë pas datës në të cilën hyn në fuqi kjo Konventë për atë shtet.

2. Denoncimi do të hyjë në fuqi me depozitimin e një instrumenti të denoncimit te depozitari.

3. Denoncimi hyn në fuqi pas një viti ose pas një periudhe më të gjatë, siç mund të specifikohet në instrumentin e denoncimit, pasi instrumenti përkatës të jetë marrë nga ana e depozitarit.

Neni 22
Gjuhët

Kjo Konventë është hartuar në një origjinal të vetëm, në gjuhët arabe, kineze, angleze, frënge, ruse dhe spanjolle, ku secili tekst është njëlloj autentik.

Hartuar në Gjenevë këtë ditë të gjashtë të majit, njëmijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e tre.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit duke qenë të autorizuar rregullisht nga qeveritë e tyre përkatëse për këtë qëllim e kanë nënshkruar këtë Konventë.

LIGJ
Nr.10 087, datë 26.2.2009

**PËR DISA NDRYSHIME NË LIGJIN NR.8328, DATË 16.4.1998 “PËR TË DREJTAT DHE
TRAJTIMIN E TË DËNUARVE ME BURGIM DHE TË PARABURGOSURVE”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83 pika 1 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Në ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

Neni 1

Në fund të nenit 19 shtohen dy paragrafë me këtë përmbajtje:

“Nëpunësit e administratës civile të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, të cilët nuk bëjnë pjesë në strukturat e Policisë së Burgjeve, gëzojnë statusin e nëpunësit civil, sipas legjislacionit në fuqi dhe janë pjesë e shërbimit civil.

Marrëdhëniet juridike të punës për punonjësit mbështetës të administratës civile, në Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve dhe për punonjësit e administratës civile, në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.”.

Neni 2

Neni 22 ndryshohet si më poshtë:

“Neni 22

Policia e Burgjeve

1. Policia e Burgjeve ka për mision ruajtjen e rendit dhe të sigurisë në institucionet e ekzekutimit të vendimeve penale, gjatë transferimeve e shoqërimeve të të dënuarve ose të të paraburgosurve, në gjykata e institucione të tjera, në përputhje me ligjin, duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

2. Mënyra e organizimit dhe e funksionimit të Policisë së Burgjeve rregullohet me ligj të veçantë.”.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6094, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

LIGJ

Nr.10 088, datë 2.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË PROTOKOLLIN SHITESË TË KONVENTËS PËR LEHTËSITË DOGANORE PËR TURIZMIN, NË LIDHJE ME IMPORTIMIN E DOKUMENTEVE E TË MATERIALEVE PUBLICITARE TURISTIKE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI

I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në protokollin shtesë të konventës për lehtësitë doganore për turizmin, në lidhje me importimin e dokumenteve e të materialeve publicitare turistike.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6095, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

PROTOKOLLI SHITESË

I KONVENTËS¹ MBI LEHTËSIRAT DOGANORE PËR TURIZMIN, NË LIDHJE ME IMPORTIMIN E DOKUMENTEVE DHE MATERIALEVE PUBLICITARE TURISTIKE, HARTUAR NË NJU-JORK MË 4 QERSHOR 1954

Shtetet kontraktuese,
në kohën e përfundimit të një konvente mbi formalitetet doganore për turizmin, nga konferenca e kombeve të bashkuara mbi formalitetet doganore për importimin e përkohshëm të automjeteve private dhe për turizmin,
me dëshirën për të lehtësuar edhe qarkullimin e dokumenteve dhe materialeve publicitare turistike,
kanë rënë dakord mbi dispozitat shtesë të mëposhtme:

Neni 1

Për qëllimin e këtij protokollit, termi “tarifat e importit dhe taksat e importit” nuk do të nënkuptojnë vetëm tarifat doganore, por edhe të gjitha tarifat dhe taksat, të çfarëdo lloji, të vendosura për arsye importimi.

1. Në përputhje me nenin 10, protokollit hyri në fuqi më 28 qershor 1956, ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit ose pranimit, dhe më pas, për çdo shtet ratifikimin dhe pranimin pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit ose pranimit, në ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit nga këto shtete të instrumenteve të tyre të ratifikimit ose pranimit.

Në vijim është lista e ratifikimeve dhe pranimeve (a) duke treguar datat e depozitimit dhe hyrjes në fuqi të Protokollit:

Shteti	Data e depozitimit	Data e hyrjes në fuqi
Belgjikë (Gjithashtu e aplikueshme në territorin e Kongos Belge dhe territorin e Trustit të Ruanda-Urundit)	21 shkurt 1955	28 qershor 1956
Japoni	7 shtator 1955	28 qershor 1956
Danimarkë (a)	13 tetor 1955	28 qershor 1956
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda Veriore (Objekt i vërejtjeve të regjistruara në aktin final; shih fq.204)	27 shkurt 1956	28 qershor 1956
Austria	30 mars 1956	28 qershor 1956
Zvicra	23 maj 1956	21 gusht 1956
Luksemburgu	21 nëntor 1956	19 shkurt 1957
India (a)	15 shkurt 1957	16 maj 1957
Egjipti	4 prill 1957	3 korrik 1957
Suedia	11 qershor 1957	9 shtator 1957
Meksika	13 qershor 1957	11 shtator 1957
Izraeli (a)	1 gusht 1957	30 tetor 1957

Shtirje e protokollit shtesë tek territoret që vijnë u njoftua nga Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlanda e Veriut më 7 gusht 1957 (për veprim më 5 nëntor 1957);

Borneo e Veriut, Qiproja, Xhamajka, Federata e Malajës, Malta, Sejshells, Siera Leone, Singapori, Protektorati Somalian, Tonga, Zanzibari.

*Shih faqen 230 të këtij volumni.

Neni 2

Çdo shtet kontraktues duhet të pranojë heqjen e tatimeve dhe taksave të importit për artikujt e mëposhtëm, në qoftë se ata janë importuar nga një shtet tjetër kontraktues dhe nuk përbëjnë asnjë rrezik për abuzim:

a) Dokumente (dosje, pamflete, libra, revista, guida, postera me dhe pa kornizë, fotografi pa kornizë dhe fotografi të zmadhuara, harta të ose të pailustruara, diapozitivë) për shpërndarje falas,

qëllimi kryesor i të cilave është inkurajimi i publikut për të vizituar shtete të tjera, ndër të tjera, për të marrë pjesë në takime apo demonstrime kulturore, turistike, sportive, fetare dhe profesionale, të zhvilluara në këto vende, në qoftë se dokumentet nuk përmbajnë më shumë se 25% material privat reklamues komercial dhe janë padyshim të projektuara për qëllime të përgjithshme publiciteti;

b) Listat dhe librat vjetorë të hoteleve të huaja, të publikuar ose të sponsorizuar nga agjenci zyrtare turistike dhe oraret e shërbimeve të transportit që operojnë jashtë vendit, kur dokumente të tilla janë për shpërndarje falas dhe nuk përmbajnë më shumë se 25% material reklamues komercial;

c) Materiale teknike që u dërgohen përfaqësuesve të akredituar ose korrespondentëve të emëruar nga agjencitë turistike zyrtare kombëtare, jo për qëllime shpërndarjeje, për shembull kalendarë, numratorë telefonikë, lista hotelesh, katalogë panairesh, modele punimesh me dorë të një vlere të papërfillshme, dokumente rreth muzeumeve, universiteteve, lixhave dhe institucioneve të ngjashme.

Neni 3

Duke iu nënshtruar kushteve të paraqitura në nenin 4, tarifave të importit dhe taksat e importit duhet të hiqen përkohësisht për materialet që vijojnë, pa lidhur kontrata përsa u përket këtyre tarifave apo taksave apo duke depozituar këto tarifa dhe taksa, kur importohen nga një shtet kontraktuese kryesisht me qëllim që të inkurajojë publikun për të vizituar atë Shtet; ndër të tjera, për të marrë pjesë në takimet dhe demonstrimet kulturore, turistike, sportive, fetare ose profesionale, që zhvillohen në atë vend.

a) Materialet me qëllim ekspozimin në zyrat e përfaqësuesve të akredituar ose korrespondentëve të emëruar nga agjencitë zyrtare kombëtare turistike ose në vende të tjera të miratuara nga autoritetet doganore të vendit për import: piktura dhe vizatime, fotografi me kornizë dhe fotografi të zmadhuara, libra arti, piktura, gdhendje dhe litografë, skulptura dhe tapiceri dhe punime të tjera artistike;

b) Materiale ekspozimi (vitrina, tezga dhe artikuj të ngjashëm), ku përfshihen pajisje elektrike dhe mekanike të nevojshme për të realizuar këtë ekspozim;

c) Filmata dokumentarë, filmime, incizime dhe regjistrime të tjera zëri, të planifikuara për përdorim në performanca, për të cilat nuk duhet të paguhet ndonjë detyrim, por duke përfshirë ato raste kur subjektet e të cilave janë të përshtatshme për hua për reklamim tregtar dhe ato që janë në shitje të zakonshme në vendin e importimit;

d) Një numër i arsyeshëm flamurësh;

e) Diorama, bocete, projektorë, blloqe printimi, negativë filmash fotografikë;

f) Mostra, në një numër të arsyeshëm, punime artizanale kombëtare, kostume lokale dhe artikuj të ngjashëm folklori.

Neni 4

1. Lehtësirat e përmendura në nenin 3 duhet të jepen në kushtet e mëposhtme:

a) Materiali duhet të dërgohet ose nga një agjenci turistike zyrtare, ose nga një agjenci publiciteti turistike kombëtare të varur nga ajo. Prova duhet të sigurohet duke paraqitur te autoritetet doganore të shtetit të importit një deklaratë të përgatitur në përputhje me modelin në aneksin e këtij protokoll nga agjencia dërguese.

b) Materiali duhet të importohet për dhe me përgjegjësinë ose të përfaqësuesit të akredituar të agjencisë turistike zyrtare kombëtare të vendit që bën dërgesën, ose të korrespondentit të caktuar nga agjencia e sipërpërmendur dhe e miratuar nga autoritetet doganore të shtetit të importimit. Përgjegjësia e përfaqësuesit të akredituar për korrespondentin e miratuar përfshin në veçanti pagesën e tarifave dhe taksave të importit, të cilat vendosen, në qoftë se kushtet e parashtruara në këtë protokoll nuk përmbushen.

c) Materiali i importuar duhet të rieksportohet pa ndryshime nga agjencia importuese. Në qoftë se materiali që është lejuar të pranohet pa pagesë shkatërrohet, sipas kushteve të parashtruara nga autoritetet doganore, importuesit duhet t'i hiqet detyrimi për të rieksportuar.

2. Privilegji i pranimit të përkohshëm pa pagesë do të jetë i vlefshëm për një periudhë prej të paktën dymbëdhjetë muajsh.

Neni 5

Në rast mashtrimi, shkeljeje ose abuzimi, shtetet kontraktuese do të jenë të lira të procedojnë për shlyerjen e tarifave të importit dhe taksave korresponduese të importit, si dhe për të vendosur gjopa mbi personat përgjegjës, të cilëve u janë bërë përgjashtime ose lehtësira të tjera.

*Shih faqen 282 të këtij volumni, nr.3992

Neni 6

Çdo shkelje e dispozitave të këtij protokollit, çdo zëvendësim, deklaratë e rreme ose akti që ka efektin t'i sjellë një personi apo një artikulli përfitime të padrejta nga sistemi i importimit të përcaktuar në këtë protokoll, mund t'i ngarkojë shkelësit në shtetin, ku është kryer shkelja, përgjegjësinë të paguajë gjopat e parashikuara nga ligjet e shtetit ku është kryer vepra penale.

Neni 7

1. Shtetet kontraktuese nuk duhet të ndërmarrin vendosjen e ndonjë mase ndaluese të karakterit ekonomik në lidhje me materialin e referuar në protokollin e paraqitur, si dhe të heqin gradualisht masat e kësaj natyre, të cilat mund të jenë ende në fuqi.

2. Dispozitat e protokollit të paraqitur nuk duhet të cenojnë në asnjë mënyrë zbatimin e ligjeve dhe rregullave në lidhje me importimin e artikujve të caktuar, kur ligje dhe rregulla të tilla caktojnë masa ndaluese, të cilat bazohen mbi konsiderata të moralit publik, sigurisë publike, shëndetit publik ose higjenës.

Neni 8

1. Ky protokoll do të jetë i hapur për nënshkrim deri më 31 dhjetor 1954 në emër të çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe çdo shteti tjetër të ftuar të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi formalitetet doganore për importimin e përkohshëm të automjeteve private dhe për turizmin, mbajtur në Nju-Jork në qershor 1954, që më poshtë do të referohet si Konferenca.

2. Ky Protokoll do të jetë objekt ratifikimi dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 9

1. Që nga 1 janari 1955, ky protokoll do të jetë i hapur për pranim nga çdo shtet i përmendur në paragrafin e parë të nenit 8 dhe çdo shtet tjetër të ftuar nga Këshilli Ekonomik-Social i Kombeve të Bashkuara. Ai do të jetë gjithashtu i hapur për pranim në emër të ndonjë territori trust, ku Kombet e Bashkuara janë autoriteti administrues.

2. Pranimi do të kryhet nga depozitimi i një instrumenti pranimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 10

1. Ky protokoll do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë që nga data e depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit apo pranimit ose pa rezervë, ose me rezervat e pranuar në përputhje me nenin 14.

2. Për çdo shtet që ratifikon apo pranon protokollin pas datës së depozitimit të instrumentit të pestë të ratifikimit apo pranimit në përputhje me paragrafin e mësipërm, protokollit do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë, pas datës së depozitimit të instrumentit të ratifikimit apo pranimit nga ky shtet, ose pa rezervë, ose me rezervat e pranuar në përputhje me nenin 14.

Neni 11

1. Tre vjet pas hyrjes në fuqi të këtij protokollit, çdo shtet kontraktues mund ta denoncojë atë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm e Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të jetë i vlefshëm pesëmbëdhjetë muaj nga data kur Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njoftohet për denoncimin.

Neni 12

Ky protokoll nuk do të ketë më efekt, në qoftë se për ndonjë periudhë dymbëdhjetë mujore që vijon nga hyrja në fuqi, numri i shteteve kontraktuese do të jetë më pak se dy.

Neni 13

1. Në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo pranimit ose në çdo periudhë kohore vijuese, çdo shtet mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që ky protokoll do të zgjerohet në të gjithë ose ndonjë nga territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës. Protokollin do të zgjerohet në territoret e përmendura në lajmërim, që nga dita e nëntëdhjetë pasi është dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në qoftë se njoftimi nuk është shoqëruar me një rezervë, ose nga dita e nëntëdhjetë pasi njoftimi është bërë i vlefshëm në përputhje me nenin 14, ose në datën në të cilën protokollin ka hyrë në fuqi në shtetin përkatës, pavarësisht se cili është i fundit.

2. Çdo shtet që ka lëshuar një deklaratë sipas paragrafit vijues, duke e zgjeruar këtë protokoll në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të denoncojë protokollin veçmas, sipas atij territori, në përputhje me dispozitat e nenit 11.

Neni 14

1. Rezervat për këtë protokoll, të bëra para nënshkrimit të aktit final duhet të jenë të lejueshme, në qoftë se janë pranuar nga shumica e anëtarëve të Konferencës dhe të regjistruara në aktin final.

2. Rezervat e bëra pas nënshkrimit të aktit final nuk do të jenë të lejueshme, në qoftë se një e treta e shteteve nënshkruese ose shteteve kontraktuese shprehin mospëlqim për sa vijon.

3. Teksti i çdo rezerve të dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara nga një shtet në kohën e nënshkrimit, depozitimi i një instrumenti ratifikimi apo pranimit sipas nenit 13 do të qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm të të gjitha shtetet që do ta kenë nënshkruar, ratifikuar apo pranuar protokollin deri në atë kohë. Në qoftë se një e treta e këtyre shteteve shpreh mospëlqim brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e qarkullimit, rezerva nuk do të pranohet. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet e referuara në këtë paragraf për çdo mospëlqim që ai ka marrë, si dhe rreth pranimit apo refuzimit të rezervës.

4. Çdo mospëlqim nga një shtet që ka nënshkruar, por jo ratifikuar protokollin, nuk do të jetë më i vlefshëm, në qoftë se brenda një periudhe nëntë mujore nga data e refuzimit të tij, shteti refuzues nuk e ka ratifikuar protokollin. Në qoftë se, si rezultat i një refuzimi që nuk është më i vlefshëm, një rezervë pranohet në zbatim të paragrafit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të informojë shtetet të cilave iu referohet ky paragraf. Teksti i çdo rezerve nuk duhet të qarkullohet te ndonjë shtet nënshkrues sipas paragrafit të mësipërm, në qoftë se ai shtet nuk e ka ratifikuar protokollin brenda tre vjetësh nga data e nënshkrimit në emër të tij.

5. Brenda periudhës 12-mujore që nga dita kur Sekretari i Përgjithshëm, duke iu referuar paragrafit 3, njofton se rezerva është refuzuar në përputhje me një procedurë të përcaktuar për të në këtë paragraf, shteti që paraqet rezervën, mund të tërheqë rezervën, sipas së cilës instrumenti i ratifikimit, pranimit, apo lajmërimit, bazuar në nenin 13, mund të jetë i vlefshëm për këtë shtet, që nga data e tërheqjes. Në pritje të kësaj tërheqjeje, qoftë instrumenti, qoftë lajmërimi, nuk do të jetë më i vlefshëm derisa rezerva të pranohet duke zbatuar dispozitat e paragrafit 4.

6. Rezervat e pranuar në përputhje me këtë nen mund të tërhiqen në çdo kohë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

7. Asnjë nga shtetet kontraktuese nuk do të kërkohet të zgjerohet në një shtet duke e kthyer rezervën në përfitim të dispozitave, mbi të cilat zbatohet një rezervë e tillë. Çdo shtet që përfiton nga kjo e drejtë duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm sipas rrethanave dhe ky i fundit duhet t'ua komunikojë këtë vendim të gjitha shteteve nënshkruese dhe kontraktuese.

*Shih faqen 192 të këtij volumni

Neni 15

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy apo më shumë shtetesh kontraktuese, përsa i përket interpretimit ose zbatimit të këtij protokollit duhet, për sa të jetë e mundur, të zgjidhet me negociata midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje, e cila nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të paraqitet për arbitrazh, në qoftë se një nga shtetet në konflikt e kërkon këtë dhe do t'u referohet me radhë një apo më shumë arbitrave të zgjedhur me marrëveshje midis shteteve në konflikt. Në qoftë se brenda tre muajsh nga data e kërkesës për arbitrazh, shtetet në konflikt nuk arrijnë të bien dakord për zgjedhjen e arbitrit, apo arbitrave një nga këto shtete mund t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të emërojë një arbitër të vetëm, të cilit mund t'i referohet për vendim mosmarrëveshja.

3. Vendimi i arbitrit apo arbitrave të caktuar sipas paragrafit të mësipërm duhet të jetë detyrues mbi shtetet kontraktuese në fjalë.

Neni 16

1. Tre vjet pasi ky protokoll të ketë hyrë në fuqi, çdo shtet kontraktues, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, kërkon mbledhjen e një konference me qëllim rishikimin e protokollit. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha shtetet kontraktuese rreth kërkesës dhe konferenca e rishikimit duhet të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm në qoftë se brenda një periudhe katërmujore që nga data e njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se gjysma e shteteve kontraktuese e lajmërojnë atë për pajtimin e tyre me kërkesën.

2. Në qoftë se një konferencë zhvillohet në përputhje me paragrafin e mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha shtetet kontraktuese dhe t'i ftojë ata të dorëzojnë brenda një periudhe tremujore propozime, të cilat ata do të dëshironin që Konferenca t'i merrte në konsideratë. Sekretari i Përgjithshëm duhet t'u shpërndajë të gjitha shteteve kontraktues agjendën provizore të konferencës, së bashku me tekstet e këtyre propozimeve, të paktën tre muaj para datës kur do të mbledhet konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të ftojë në çdo konferencë të zhvilluar sipas këtij neni të gjitha shtetet kontraktuese dhe të gjitha shtetet anëtare të tjera të Kombeve të Bashkuara, ose të secilës nga agjencitë e specializuara.

Neni 17

1. Çdo shtet kontraktues mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë protokoll. Teksti i çdo amendamenti duhet të transmetohet te Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet ta qarkullojë atë tek të gjitha shtetet kontraktuese.

2. Çdo amendament i propozuar, i qarkulluar në përputhje me paragrafin e mësipërm, duhet të çmohet i pranuar, në qoftë se asnjë nga shtetet kontraktuese nuk shpreh kundërshtime brenda një periudhe gjashtëmujore, duke vijuar nga data e shpërndarjes së amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë sa më parë të jetë e mundur të gjitha shtetet kontraktuese, në qoftë se është shprehur ndonjë refuzim për amendamentin e propozuar, dhe në qoftë se nuk është shprehur asnjë refuzim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet kontraktuese tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtëmujore, caktuar në paragrafin e mësipërm.

Neni 18

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftojë të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha shtetet e tjera të ftuara të marrin pjesë në konferencën mbi:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet e marra në përputhje me nenet 8 dhe 9;
- b) datën në të cilën ky protokoll do të hyjë në fuqi, në bazë të nenit 10;
- c) denoncimet e marra në përputhje me nenin 11;
- d) shfuqizimin e këtij protokollit në përputhje me nenin 12;
- e) njoftimet e marra në bazë të nenit 13;
- f) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti në përputhje me nenin 17.

Neni 19

Origjinali i këtij protokollit duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili duhet të transmetojë kopje të certifikuara të tij tek të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe tek të gjitha shtetet e tjerë të ftuara në konferencë.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë protokoll.

Bërë në Nju-Jork, më katër qershor, njëmijë e nëntë qind e pesëdhjetë e katër, në një kopje të vetme, në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle; çdo tekst i njëjtë me origjinalin.

Sekretarit të Përgjithshëm i kërkohet të përgatisë një përkthim besnik me origjinalin të këtij protokollit në gjuhët kineze dhe ruse, si dhe të shtojë tekstet në gjuhët ruse dhe kineze të tekstet në gjuhën angleze, franceze dhe spanjolle, kur të transmetojë kopjet e certifikuara tek shtetet në përputhje me nenin 19 të këtij protokollit.

ANEKSI

MODELI I DEKLARATËS

(Për t'u plotësuar në gjuhën e shtetit eksportues me një përkthim në anglisht ose frëngjisht)

DEKLARATË

Për pranimin e përkohshëm pa pagesë të materialeve turistike publicitare, pa lidhur kontratë për tarifën e importit dhe taksat e importit apo depozitimit të tarifave dhe taksave të tilla

(Emri i organizatës) që dërgon materialin publicitar turistik, adresuar përfaqësuesit të saj të akredituar (ose korrespondentit të miratuar), emri i të cilit është shkruar më poshtë, për import të përkohshëm, me kushtin që ai do të riekportohet brenda një periudhe dymbëdhjetë mujore dhe që do të përdoret vetëm me qëllimin e nxitjes së turistëve, për të vizituar shtetin ku eksportohet materiali.

(Emri i organizatës) nuk merr përsipër, qoftë pa pagesë, qoftë me pagesë, që të eliminojë artikujt e importuar përkohësisht pa miratimin e administratës doganore të shtetit që importon materialin, si dhe pa plotësuar të gjitha formalitetet e kërkuara nga administrata.

Këto materiale importohen përkohësisht me përgjegjësi dhe kundrejt garancisë së përfaqësuesit të akredituar apo korrespondentit të miratuar, emri i të cilit është shënuar më poshtë.

a) Lista e materialeve:

b) Emri dhe adresa e përfaqësuesit të akredituar ose korrespondentit të miratuar, tek i cili do të dorëzohet materiali:

[Data, firma dhe vula e agjencisë zyrtare kombëtare
turistike të shtetit që bën dërgesën]

Për Afganistanin:

Për Shqipërinë:

Për Argjentinën:

Luis J. Estevarena

Për Australinë:

Për Austrinë: Dr. J. Stangelberger

Për Mbretërinë e Belgjikës:

Objekt ratifikimi

Ch. Hopchet

Për Bolivinë:
Për Brazilin:
Për Bullgarinë:
Për Bashkimin e Burmas:
Për Republikën Socialiste të Sovjetit Bjellorus:
Për Kamboxhian:

Iem Kadul

Për Kanadanë:
Për Cëlonin:
Për Kilin:
Për Kinën:
Për Kolumbinë
Për Kosta Rikën:

Për shqyrtim
J. F. Carballo
20 korrik 1954

Për Kubën:

Jose Miguel Ribas
O. Nodarse, tetor 12/54

Për Çekosllovakinë:
Për Danimarkën:
Për Republikën Domenikane:

Për Ekuadorin:

B. Oquendo

Për Egjiptin:

Rachad Mourad

Për El Salvadorin:
Për Etiopinë:
Për Finlandën:
Për Francën:

Filipe de Seynes

Për Republikën Federale të Gjermanisë:

Richard Paulig
Walter Wagner

Për Greqinë:
Për Guatemalën:

Për Haitin:

Ernest G. Chauvet

Për Hondurasin:

Tiburcio Carias Jr.
15 qershor 1954

Për Hungarinë:
Për Islandën:
Për Indinë:

Për Indonezinë:
Për Iranin:
Për Irakun:
Për Irlandën:
Për Izraelin:
Për Italinë:

Ugo Calderoni

Për Japoninë:

Renzo Sawada
2 dhjetor 1954

Për Mbretërinë Hashemite të Jordanisë:
Për Republikën e Koresë:
Për Laosin:

Për Libanin:
Për Liberinë:
Për Libinë:

Për Principatën e Madhe të Luksemburgut

Objekt ratifikimi
J. Kremer
6.12.1954

Për Meksikën:

Jose A. Bufort

Për Monakon:

Marcel A. Palmaro

Për Nepalin:
Për Mbretërinë e Holandës:

Paymans

Për Zelandën e Re:
Për Nikaraguan:

Për Mbretërinë e Norvegjisë:
Për Pakistanin:

Për Panamanë:

Për shqyrtim
Ernesto de la Ossa

Për Paraguain:
Për Perunë:
Për Republikën e Filipineve:

Mauro Mendez

Për Poloninë:
Për Portugalinë:
Për Rumaninë:

Për San Marinon:
Për Arabinë Saudite:
Për Spanjën:
Për Suedinë:

G. De Sydow

Për Zvicrën:

Fr. Luthi

Për Sirinë:
Për Tailandën:
Për Turqinë:
Për Republikën Socialiste Sovjetike të Ukrainës:
Për Bashkimin e Afrikës së Jugut:
Për Bashkimin e Republikave Socialiste Sovjetike:

Për Mbretërinë e Bashkuar të Britanisë së Madhe dhe Irlandën Veriore:

Objekt i vërejtjeve të shënuara në aktin final
Charli Henri Blake

Për Shtetet e Bashkuara të Amerikës:
Për Uruguain:

Për shqyrtim
E. Rodriguez Fabregat

Për Qytetin e Vatikanit:

Monsinjor Tomas J. McMahon

Për Venezuelën:
Për Vietnamin:
Për Jemenin:
Për Jugosllavinë:

LIGJ

Nr.10 089, datë 2.3.2009

PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË KONVENTËN PËR LEHTËSITË DOGANORE PËR TURIZMIN

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në konventën për lehtësitë doganore për turizmin.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6096, datë 17.3.2009 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

KOMISIONI EKONOMIK PËR EUROPËN
KOMITETI I TRANSPORTIT TOKËSOR

KONVENTA MBI LEHTËSIRAT DOGANORE PËR TURIZMIN
Hartuar në Nju-Jork, më 4 Qershor 1954

KOMBET E BASHKUARA
KONVENTA¹ MBI LEHTËSIRAT DOGANORE PËR TURIZMIN

Shtetet kontraktuese,
duke dëshiruar të lehtësojnë zhvillimin e turizmit ndërkombëtar,
kanë vendosur të lidhin një Konventë dhe kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Për qëllimin e kësaj Konvente:

a) Termi “tarifat e importit dhe taksat e importit” nënkupton jo vetëm tarifat doganore, por edhe të gjitha llojet e tatimeve dhe taksave të vendosura për arsye importimi.

b) Termi “turist” nënkupton çdo person, pa dallim race, gjinie, gjuhe apo feje, i cili hyn në territorin e një shteti kontraktues, që nuk është shteti ku personi banon, dhe qëndron aty jo më pak se 24 orë dhe jo më shumë se gjashtë muaj, në vijim të një periudhe 12-mujore, për arsye legjitime jo

1. Në përputhje me nenin 16 (1), Konventa hyri në fuqi më 11 shtator 1957, ditën e nëntëdhjetë pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit ose pranimit përsa u përket shteteve që vijojnë, në emër të të cilave ishin depozituar në datat e mëposhtme instrumentet e ratifikimit ose pranimit (a):

Austria	30 mars 1956
Belgjika (Gjithashtu e aplikueshme me rezerva * në territorin e Kongos belge dhe në territorin e trustit të Ruanda-Urundit)	21 shkurt 1955
Kamboxhia	29 nëntor 1955
Kanada (a)	1 qershor 1955
Cejloni	28 nëntor 1955
Danimarka (Subjekt për rezervë*)	13 tetor 1955
Egjipti (Subjekt për rezervën e regjistruar në aktin final)	4 prill 1957
Japonia	7 shtator 1955
Luksenburgu	21 nëntor 1956
Meksiko	13 qershor 1956
Suedi (Subjekt për rezervën e regjistruar në aktin final; faqen 202)	11 qershor 1957
Zvicër	23 maj 1956
Mbretëria e Bashkuar e Britanisë së Madhe dhe Irlandës Veriore	27 shkurt 1957
Shtetet e Bashkuara të Amerikës (Shtrirjet në territoret e Alaskës, Havait, Porto Rikos dhe Ishujt Virxhinia)	25 korrik 1956
Vietnam (a)	31 janar 1956

Në vijim, instrumentet e pranimit nga Izraeli janë depozituar më 1 gusht 1957, me veprim më 30 tetor 1957.

*VËREJTJE

(Këto vërejtje u pranuan në përputhje me dispozitat e nenit 20 të Konventës)

emigracioni, si turizëm, pushime, aktivitete sportive, arsye shëndetësore, arsye familjare, studime, pelegrinazhe fetare ose biznes.

c) Termi “Leje e përkohshme importi” nënkupton dokumentin doganor, i cili vërteton garancinë ose depozitën e tatimeve të importit dhe taksave të importit, të caktuara në rast dështimi të rieksportimit të artikullit të importuar përkohësisht.

BELGJIKË

(Përkthim)

1. Me depozitimin e instrumenteve përmes së cilës Belgjika ratifikon Konventën në lidhje me lehtësirat doganore për turizmin, lidhur në Nju-Jork më 4 qershor 1954, unë duhet të deklaroj që kjo Konventë është e zbatueshme në territorin e Kongos belge dhe territorin e trustit të Ruanda-Urundit, duke iu nënshtruar rezervave të mëposhtme:

1) importimi i përkohshëm i armëve të zjarrit dhe municioni i tyre nuk mund të shqyrtohen pa një dokument të importit të përkohshëm (neni 2 i Konventës);

2) përjashtimi në këtë rast i verës, pijeve alkoolike, ujit të tualetit dhe parfumit duhet të vazhdojë të kufizohet në kontenierë të hapur dhe në veçanti, në rastin e pijeve alkoolike, duhet të zbatohen dispozitat ligjore në fuqi (neni 3 i Konventës);

3) fildishi i punueshëm dhe objektet e artit indigjen duhet të përjashtohen nga funksionimi i Konventës (neni 4).

Neni 2

1. Duke iu nënshtruar kushteve të tjera të parashtruara në këtë Konventë, çdo shtet kontraktues duhet të lejojë heqjen e përkohshme të tarifave të importit dhe taksave të importit për mjetet personale të importuara nga një turist, me kusht që ato të jenë për përdorimin personal të turistit, të mbahen nga personi ose të jenë në bagazhet që shoqërojnë turistin, të mos përbëjnë arsye për t'u shqetësuar për ndonjë abuzim, si dhe këto mjete personale të rieksportohen nga turisti me largimin nga vendi.

2. Termi “mjete personale” nënkupton të gjitha rrobat dhe artikujt e tjerë, të rinj ose të përdorur, të cilët mund t'i nevojiten turistit personalisht dhe me arsye, duke pasur parasysh të gjitha kushtet e vizitës së tij, por duke përjashtuar të gjitha mallrat e importuara për qëllime tregtare.

3. Midis të tjerash, mjetet personale do të përfshijnë të gjithë artikujt e mëposhtëm, në qoftë se do të konsiderohen për përdorim personal:

- bizhuteri personale;
- një aparat fotografik me 12 disqe ose pesë negativa filmi;
- një palë dylbi;
- një instrument muzikor portativ;
- një gramafon portativ me dhjetë pllaka;
- një aparat portativ inçizimi;
- një radiomarrës portativ;
- një makinë shkrimi portative;
- një tezgë;
- një tendë dhe pajisje të tjera kampingu;

1. Unë duhet të deklaroj më tej që protokollin shtesë për Konventën, në lidhje me importin e dokumenteve dhe materialeve publicitare turistike, përfunduar në Nju-Jork më 4 qershor 1954, është i aplikueshëm në territoret e kongos belge dhe Ruanda-Urundit.

2. Në lidhje me aplikimin në territorin e Kongos belge dhe territorin e trustit të Ruanda-Urundit të konventës doganore për importin e përkohshëm të mjeteve rrugore private, përfunduar në Nju-Jork më 4 qershor 1954, unë mendoj se në kushtet e tanishme sistemi i qarkullimit të lirë ndërkombëtar të mjeteve motorike nuk do të shtrihet tek personat juridikë. E drejta e përkohshme pa pagesë nuk do të pranohet përse u përket pjesëve të importuara për riparimin e një mjeti me dokumente të lira qarkullimi.

Kufizimi i dytë natyrisht nuk aplikohet tek pjesët përbërëse që shoqërojnë mjetet kur ato janë renditur në faturën e dokumentit ndërkombëtar të qarkullimit.

DANIMARKË (Përkthim)

Pavarësisht nga dispozitat e nenit 3 të kësaj Konvente, vendet skandinave do të lejohen të kenë rregulla të veçanta të zbatueshme për personat banues në ato vende.

* Amendimi në nenin 2, hyrë në fuqi më 6 qershor 1967.

Pajisje sportive (pajime peshkimi, një armë sportive me 50 fishekë, një biçikletë jomotorike, një kanoe ose një kaike më pak se 5 ½ metra i gjatë, një palë ski, dy raketa tenisi dhe artikuj të tjerë të ngjashëm).

Neni 3

Duke iu nënshtruar kushteve të tjera të parashtuara në këtë Konventë, çdo shtet kontraktues duhet të lejojë heqjen e tarifave të importit dhe taksave të importit për artikujt e mëposhtëm të importuar nga një turist për përdorim personal, me kusht që këta artikuj të mbahen nga personi ose në bagazhet e dorës që shoqërojnë turistin dhe me kusht që të mos përbëjnë arsye për ndonjë abuzim:

a) 200 cigare ose 50 puro, 250 gramë duhan ose një lloj tjetër i këtyre produkteve, në qoftë se pesha totale nuk i kalon 250 gram;

b) një shishe vere me përmasa normale dhe një çerek litër pije alkoolike;

c) Një çerek litër kolonjë dhe një sasi e vogël parfumi.

Neni 4

Duke iu nënshtruar kushteve të tjera të parashtuara në këtë Konventë, çdo shtet kontraktues, në qoftë se nuk ka arsye për t'u shqetësuar për ndonjë abuzim, duhet të pajisë turistin me:

a) autorizimin për të importuar tranzit dhe pa leje të përkohshme importimi suvenire udhëtimi me një vlerë totale që nuk i kalon 50 dollarë amerikanë, me kusht që suvenire të tilla të mbahen nga personi ose në bagazhet që shoqërojnë turistin dhe që të mos përdoren për qëllime tregtare.

b) autorizimin për të eksportuar, pa formalitetet e zbatuara në kontrollet e valutës dhe të përjashtuara nga taksa e eksportit, suvenire udhëtimi, të cilat turisti i ka blerë brenda shtetit për një vlerë totale jo më të madhe se 100 dollarë amerikanë, me kusht që këta artikuj të mbahen nga personi ose në bagazhet që shoqërojnë turistin dhe që të mos përdoren për qëllime tregtare.

Neni 5

Çdo shtet kontraktues mund të kërkojë një lejë të përkohshme importi për artikujt me vlerë të lartë, të përfshirë në nenin 2.

Neni 6

Shtetet kontraktuese duhet të përpiqen të mos vënë në zbatim procedura doganore, të cilat mund të pengojnë zhvillimin e turizmit ndërkombëtar.

Neni 7

Shtetet kontraktuese fqinje duhet të përpiqen të ngrenë postat e tyre kufitare pranë njëra-tjetrës dhe t'i mbajnë ato të hapura gjatë të njëjtit orar, në mënyrë që të përshpejtojnë procedurat doganore.

Neni 8

Dispozitat e kësaj Konvente nuk duhet të cenojnë në asnjë mënyrë zbatimin e rregullave policore e të tjera, në lidhje me importin, zotërimin dhe mbajtjen e armëve dhe municionit.

Neni 9

Çdo shtet kontraktues pranon se çdo masë ndaluese që ai shtet ka vendosur mbi eksportin e artikujve që përfitojnë nga kjo Konventë, duhet të zbatohet vetëm për sa kohë masat do të bazohen mbi faktorë të ndryshëm nga ata me natyrë ekonomike, si për shembull morali publik, siguria publike, shëndeti publik, higjiena, faktorë veterinarë dhe fito-patologjikë.

Neni 10

Përfjashtimet dhe lehtësirat e mundësuar nga kjo Konventë nuk duhet të zbatohen për trafikun në kufi.

Këto përfjashtime dhe lehtësira nuk duhet të zbatohen menjëherë në rastet:

- a) kur sasia totale e një malli për t'u importuar nga një turist e kalon ndjeshëm kufirin e përcaktuar në këtë Konventë;
- b) në rast se turisti hyn në shtetin e importit më shumë se një herë në muaj;
- c) në rast se turisti është nën 17 vjeç.

Neni 11

Në rast falsifikimi, kontradikte ose abuzimi, shtetet kontraktuese do të jenë të lira të procedojnë për shlyerjen e tarifave të importit dhe taksave korresponduese të importit, si dhe për të vendosur gjopa mbi personat përgjegjës, që iu është bërë përfjashtim, ose lehtësira të tjera.

Neni 12

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Konvente, çdo zëvendësim, deklaratë e rreme ose akt që ka efektin t'i sjellë një personi apo një artikulli, përfitime të padrejta nga sistemi i importimit, përcaktuar në këtë Konventë, mund t'i ngarkojë shkelësit në shtetin ku është kryer shkelja, përgjegjësinë të paguajë gjokat e parashikuara nga ligjet e atij shteti.

Neni 13

Kjo Konventë nuk mund të ndalojë shtetet kontraktuese, të cilat formojnë një union doganor apo ekonomik, të miratojnë dispozita të zbatueshme për rezidentët e shteteve që formojnë unionin.

Neni 14

1. Kjo Konventë do të jetë e hapur për nënshkrim deri në datën 31 dhjetor 1954, në emër të çdo shteti anëtar të Kombeve të Bashkuara dhe të ndonjë shteti tjetër të ftuar për të marrë pjesë në Konferencën e Kombeve të Bashkuara mbi formalitetet doganore për importimin e përkohshëm të automjeteve private dhe për turizmin, që u mbajt në Nju-Jork në maj dhe qershor të vitit 1954, që këtu referohet si Konferenca.

2. Kjo Konventë do t'i nënshtrohet ratifikimeve dhe instrumentet e ratifikimit do të depozitohen pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 15

1. Që nga janari 1955, kjo Konventë do të jetë e hapur për pranim nga cilido shtet që i është referuar në paragrafin 1 të nenit 14 dhe çdo shtet tjetër i ftuar nga Këshilli Ekonomik dhe Social i Kombeve të Bashkuara. Ajo do të jetë gjithashtu e hapur për pranim në emër të çdo territori trust, në të cilin Kombet e Bashkuara janë autoriteti administrues.

2. Pranimi do të kryhet nga depozitimi i një instrumenti pranimi pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

Neni 16

1. Kjo Konventë do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë që nga data e depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit apo pranimit ose pa rezervë, ose me rezervat e pranuar në përputhje me nenin 20.

2. Për çdo shtet që ratifikon apo pranon këtë Konventë pas datës së depozitimit të instrumentit të pesëmbëdhjetë të ratifikimit apo pranimit në përputhje me paragrafin e mësipërm, Konventa do të hyjë në fuqi ditën e nëntëdhjetë nga data kur ky shtet depoziton instrumentin e tij të ratifikimit apo pranimit ose pa rezervë, ose me rezervat e pranuar në përputhje me nenin 20.

Neni 17

1. Tre vjet pas hyrjes në fuqi të kësaj Konvente, çdo shtet kontraktues mund ta denoncojë atë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara.

2. Denoncimi do të jetë i vlefshëm pesëmbëdhjetë muaj nga data kur Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara njoftohet për denoncimin.

Neni 18

Kjo Konventë nuk do të ketë më efekt në qoftë se për ndonjë periudhë 12-mujore që vijon nga hyrja në fuqi, numri i shteteve kontraktuese do të jetë më pak se tetë.

Neni 19

1. Në kohën e depozitimit të instrumentit të tij të ratifikimit apo pranimit ose në çdo periudhë kohore vijuese, çdo shtet mund të deklarojë me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara që kjo Konventë do të zgjerohet në të gjithë ose ndonjë nga territoret, për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës. Konventa do të zgjerohet në territoret e përmendura në lajmërim, që nga dita e nëntëdhjetë pasi është dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, në qoftë se njoftimi nuk është shoqëruar me një rezervë ose nga dita e nëntëdhjetë pasi njoftimi është bërë i vlefshëm në përputhje me nenin 20, ose në datën në të cilën Konventa ka hyrë në fuqi në shtetin përkatës, pavarësisht se cila është e fundit.

2. Çdo shtet që ka lëshuar një deklaratë sipas paragrafit vijues, duke e zgjeruar këtë konventë në çdo territor për marrëdhëniet ndërkombëtare të të cilit është përgjegjës, mund të denoncojë Konventën veçmas, sipas atij territori, në përputhje me dispozitat e nenit 17.

Neni 20

1. Rezervat për këtë Konventë, të bëra para nënshkrimit të aktit final, duhet të jenë të lejueshme, në qoftë se janë pranuar nga shumica e anëtarëve të Konferencës dhe të regjistruara në aktin final.

2. Rezervat e bëra pas nënshkrimit të aktit final nuk do të jenë të lejueshme, në qoftë se një e treta e shteteve nënshkruese ose shteteve kontraktuese shprehin mospëlqim, për sa vijon.

3. Teksti i çdo rezerve të dorëzuar pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara nga një shtet në kohën e nënshkrimit, depozitimi i një instrumenti ratifikimi apo pranimi sipas nenit 19 do të qarkullohet nga Sekretari i Përgjithshëm të të gjitha shtetet që deri në atë kohë do ta kenë nënshkruar, ratifikuar apo pranuar Konventën. Në qoftë se një e treta e këtyre shteteve shpreh mospëlqim brenda nëntëdhjetë ditëve nga data e qarkullimit, rezerva nuk do të pranohet. Sekretari i Përgjithshëm do të njoftojë të gjitha shtetet e referuara në këtë paragraf për çdo mospëlqim që ai ka marrë, si dhe rreth pranimit apo refuzimit të rezervës.

4. Çdo mospëlqim nga çdo shtet që ka nënshkruar, por jo ratifikuar Konventën, nuk do të jetë më i vlefshëm, në qoftë se brenda një periudhe nëntë mujore nga data e refuzimit të tij, shteti refuzues nuk e ka ratifikuar Konventën. Në qoftë se si rezultat i një refuzimi që nuk është më i vlefshëm, një rezervë pranohet në zbatim të paragrafit të mësipërm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të informojë shtetet të cilave iu referohet ky paragraf. Teksti i çdo rezerve nuk duhet të qarkullohet te ndonjë shtet nënshkrues sipas paragrafit të mësipërm, në qoftë se ai shtet nuk e ka ratifikuar Konventën brenda tre vjetësh nga data e nënshkrimit në emër të tij.

5. Brenda periudhës 12-mujore që nga dita kur Sekretari i Përgjithshëm, duke iu referuar paragrafit 3, njofton se rezerva është refuzuar në përputhje me një procedurë të përcaktuar për të në këtë paragraf, shteti që paraqet rezervën mund të tërheqë rezervën, sipas së cilës instrumenti i ratifikimit, pranimit apo lajmërimit, bazuar në nenin 19, mund të jetë i vlefshëm për këtë shtet, që nga data e tërheqjes. Në pritje të kësaj tërheqjeje, qoftë instrumenti, qoftë lajmërimi, nuk do të jetë më i vlefshëm derisa rezerva të pranohet duke zbatuar dispozitat e paragrafit 4.

6. Rezervat e pranuar në përputhje me këtë nen mund të tërhiqen në çdo kohë duke njoftuar Sekretarin e Përgjithshëm.

7. Asnjërit nga shtetet kontraktuese nuk do t'i kërkohet të zgjerohet me një shtet duke e kthyer rezervën në përfitim të dispozitave mbi të cilat zbatohet një rezervë e tillë. Çdo shtet që përfiton nga kjo e drejtë duhet të njoftojë Sekretarin e Përgjithshëm në përputhje me rrethanat dhe ky i fundit duhet t'ua komunikojë këtë vendim të gjitha shteteve nënshkruese dhe kontraktuese.

Neni 21

1. Çdo mosmarrëveshje midis dy apo më shumë shtetesh kontraktuese, përsa i përket interpretimit ose zbatimit të kësaj Konvente, për sa të jetë e mundur, duhet të zgjidhet me negociata midis tyre.

2. Çdo mosmarrëveshje, e cila nuk zgjidhet me anë të negociatave, duhet të paraqitet për arbitrazh, në qoftë se një nga shtetet në konflikt e kërkon këtë dhe do t'i referohet me radhë një apo më shumë arbitrave të zgjedhur me marrëveshje midis shteteve në konflikt. Në qoftë se brenda tre muajsh nga data e kërkesës për arbitrazh, shtetet në konflikt nuk arrijnë të bien dakord për zgjedhjen e arbitrit apo arbitrave, një nga këto shtete mund t'i kërkojë Kryetarit të Gjykatës Ndërkombëtare të Drejtësisë që të emërojë një arbitër të vetëm, të cilit mund t'i referohet për vendim mosmarrëveshja.

3. Vendimi i arbitrit apo arbitrave të caktuar sipas paragrafit të mësipërm duhet të jetë detyrues mbi shtetet kontraktuese në fjalë.

Neni 22

1. Tre vjet pasi kjo Konventë ka hyrë në fuqi, çdo shtet kontraktues, me anë të një njoftimi drejtuar Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, kërkon mbledhjen e një konference me qëllim rishikimin e Konventës. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha shtetet kontraktuese rreth kërkesës dhe konferenca e rishikimit duhet të mbledhet nga Sekretari i Përgjithshëm në qoftë se, brenda një periudhe katër mujore nga data e njoftimit nga Sekretari i Përgjithshëm, jo më pak se gjysma e shteteve kontraktuese e lajmërojnë atë për pajtimin e tyre me kërkesën.

2. Në qoftë se një konferencë zhvillohet në përputhje me paragrafin e mëparshëm, Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë të gjitha shtetet kontraktuese dhe t'i ftojë ato të dorëzojnë brenda një periudhe tri mujore propozime, të cilat ata do të dëshironin që Konferenca t'i merrte në konsideratë. Sekretari i Përgjithshëm duhet t'u shpërndajë të gjitha shteteve kontraktuese agjendën provizore të konferencës, së bashku me tekstin e këtyre propozimeve, të paktën tre muaj para datës kur do të mbledhet konferenca.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të ftojë në çdo konferencë të zhvilluar sipas këtij neni të gjitha shtetet kontraktuese dhe të gjitha shtetet anëtare të tjera të Kombeve të Bashkuara ose të secilës prej agjencive të specializuara.

Neni 23

1. Çdo shtet kontraktues mund të propozojë një ose më shumë amendamente për këtë Konventë. Teksti i çdo amendamenti duhet të transmetohet tek Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara, i cili duhet t'ua shpërndajë atë të gjitha shteteve kontraktuese.

2. Çdo amendament i propozuar, i qarkulluar në përputhje me paragrafin e mësipërm, duhet të gjykohet i pranuar, në qoftë se asnjë nga shtetet kontraktuese nuk shpreh kundërshtime brenda një periudhe gjashtë mujore, duke vijuar nga data e shpërndarjes së amendamentit të propozuar nga Sekretari i Përgjithshëm.

3. Sekretari i Përgjithshëm duhet të njoftojë sa më parë që të jetë e mundur të gjitha shtetet kontraktuese, në qoftë se është shprehur ndonjë refuzim për amendamentin e propozuar dhe në qoftë se nuk është shprehur asnjë refuzim i tillë, amendamenti do të hyjë në fuqi për të gjitha shtetet kontraktuese tre muaj pas përfundimit të periudhës gjashtë mujore, caktuar në paragrafin e mësipërm.

Neni 24

Sekretari i Përgjithshëm i Kombeve të Bashkuara duhet të njoftojë të gjitha shtetet anëtare të Kombeve të Bashkuara dhe të gjitha shtetet e tjera të ftuara të marrin pjesë në konferencën mbi:

- a) nënshkrimet, ratifikimet dhe pranimet, e marra në përputhje me nenet 14 dhe 15;
- b) datën në të cilën kjo Konventë do të hyjë në fuqi, në bazë të nenit 16;
- c) denoncimet e marra në përputhje me nenin 17;
- d) shfuqizimin e kësaj Konvente në përputhje me nenin 18;
- e) njoftimet e marra në bazë të nenit 19;
- f) hyrjen në fuqi të çdo amendamenti në përputhje me nenin 23.

Neni 25

Originali i kësaj Konvente duhet të depozitohet pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Kombeve të Bashkuara, i cili duhet të transmetojë kopje të vërtetuara të saj tek të gjithë anëtarët e Kombeve të Bashkuara dhe tek të gjitha shtetet e tjera të ftuara në konferencë.

Në dëshmi sa më sipër, të nënshkruarit, duke qenë plotësisht të autorizuar, kanë nënshkruar këtë Konventë.

Përfunduar në Nju-Jork, më katër qershor, njëmijë e nëntë qind e pesëdhjetë e katër, në një kopje të vetme, në gjuhën angleze, frënge dhe spanjolle; çdo tekst i njëjtë me origjinalin.

Sekretarit të Përgjithshëm i kërkohet të përgatisë një përkthim besnik me origjinalin e kësaj konvente në gjuhët kineze dhe ruse, si dhe të shtojë tekstet në gjuhët ruse dhe kineze të tekstet në gjuhët angleze, frënge dhe spanjolle, kur të transmetojë kopjet e vërtetuara të shtetet në përputhje me nenin 25 të kësaj Konvente.

VENDIM

Nr.224, datë 19.2.2009

PËR PROCEDURAT E KRIJIMIT TË AKTEVE TË MARRJES SË TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI, SI PASOJË E KORRIGJIMEVE, TË KRYERA NGA KOMISIONI VENDOR I VLERËSIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË (KV)

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 4, e 16, pika 1 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, me propozimin e zëvendëskryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Për qëllime të zbatimit të këtij vendimi, me termin “ngastra të tokës bujqësore, të pandara”, kuptohen parcelat e tokës bujqësore që:

a) janë ndarë nga komisionet e tokës, të krijuara sipas ligjit nr.7501, datë 19.7.1991 “Për tokën”, të cilat janë objekt mosmarrëveshjes, por që gjykata, me vendim gjyqësor, të formës së prerë, ka vendosur rishqyrtimin në rrugë administrative;

b) janë në përdorim dhe shfrytëzim faktik nga subjektet ligjore të trajtimit me tokë në pronësi, për të cilat komisioni i tokës ende nuk ka përfunduar plotësimin e dokumentacionit ligjor dhe nuk ka lëshuar aktin e marrjes së tokës në pronësi.

2. Në rastet kur kërkohet korrigjimi i aktit të marrjes së tokës në pronësi, pranë komisionit vendor të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV), krijohet dokumentacioni i ri ligjor, në bazë të të cilit lëshohet akti i ri i marrjes së tokës në pronësi.

3. Pranë komisionit vendor, qytetari paraqet:

- a) Kërkesën për korrigjimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi;
- b) Certifikatën e gjendjes familjare, të lëshuar nga zyra e gjendjes civile, e komunës dhe/ose bashkisë, ku të pasqyrohet numri i frymëve të familjes bujqësore ose individit, në favor të të cilit do të lëshohet akti i ri i marrjes së tokës në pronësi, sipas gjendjes më:
 - 1.8.1991, për ish-anëtarët e kooperativës bujqësore;
 - 1.10.1992, për punonjësit e ish-ndërmarrjeve bujqësore.
- c) Aktin e marrjes së tokës në pronësi, në origjinal, së bashku me planvendosjen e ngastrës/ngastrave, të konfirmuar nga kryetari i komunës;
- ç) Planvendosjen e ngastrës/ave, që qytetari pretendon se është e pandarë, e hartuar sipas hartës treguese të regjistrimit, në shkallën 1:2500, nga një specialist topograf i licencuar;
- d) Vërtetimin e faktit se ka qenë anëtar i ish-kooperativës bujqësore, më 1.8.1991 ose punonjës i ish-ndërmarrjes bujqësore, më 1.10.1992.

Për këtë, qytetari duhet të depozitojë shkresën, nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore, për pagesën ose jo të pensionit, si dhe konfirmimin, cilido qoftë ai, të kryetarit të komunës, për këtë fakt. Nëse, sipas informacioneve të mësipërme, nuk vërtetohet fakti se ka qenë anëtar i ish-kooperativës bujqësore ose punonjës i ish-ndërmarrjes bujqësore, qytetari ka të drejtë të depozitojë, pranë komisionit vendor, çdo dokument, që vërteton faktin e mësipërm.

4. Komisioni vendor i kërkon kryetarit të komunës/bashkisë:

- a) sipërfaqen e tokës bujqësore, të vënë në dispozicion për t'u ndarë më 1.8.1991, sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, sipas fshatrave (subjekteve), për ish-ndërmarrjet bujqësore;
- b) numrin e frymëve më 1.8.1991 sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, sipas fshatrave (subjekteve), për ish-ndërmarrjet bujqësore;
- c) normën e tokës bujqësore, në m², për frymë, më 1.8.1991, sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, sipas fshatrave (subjekteve), për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke specifikuar treguesit e domosdoshëm, të përcaktuar në vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave;

ç) konfirmimin se është lëshuar apo jo akti i marrjes së tokës në pronësi, në sipërfaqen e tokës, objekt pretendimi, për persona të tjerë nga 1.8.1991;

d) t'i vërë në dispozicion ngastrat e tokës bujqësore, aktualisht të pandara, të pavëna në dispozicion të Agjencisë Kombëtare të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, si fond i kompensimit fizik;

dh) çdo informacion tjetër, që gjykohet i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesës.

5. Komisioni vendor i kërkon seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës (më poshtë SAMT), në këshillin e qarkut:

a) konfirmimin e zërit kadastral, si për ngastrën/ngastrat, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, të paraqitur, edhe për ngastrën/ngastrat e pretenduar;

b) sipërfaqen e tokës bujqësore, të vënë në dispozicion për t'u ndarë më 1.8.1991, sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, sipas fshatrave (subjekteve), për ish-ndërmarrjet bujqësore;

c) normën e tokës bujqësore, në m², për frymë, më 1.8.1991, sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, sipas fshatrave (subjekteve), për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke specifikuar treguesit e domosdoshëm, të përcaktuar në vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave.

6. Komisioni vendor i kërkon zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme (më poshtë ZVRPP) konfirmimin e gjendjes juridike aktuale të pronësisë, për ngastrën/ngastrat, objekt pretendimi.

7. Komisioni vendor, në bazë të dokumentacionit të ri, të krijuar pranë tij, vendos për korrigjimin ose jo të aktit të marrjes së tokës në pronësi. Ky vendim duhet të përmbajë:

a) Familjen bujqësore, që fiton të drejtën e pronësisë, ku janë pasqyruar të gjithë pjesëtarët dhe pjesët takuese, që ata kanë në këtë bashkëpronësi;

b) Sasinë dhe zërin kadastral (arë, pemëtore, ullishte, vreshtë) të tokës bujqësore shtesë, për të cilën do të vendoset të jepet akti i ri i marrjes së tokës në pronësi;

c) Emrat e pronarëve kufitarë të pronës, sipas numrave kadastralë të ngastrave;

ç) Planvendosjen e ngastrës/ngastrave, të ngjyrosur e të dallueshme nga ngastrat kufitare.

8. Ky vendim i komisionit vendor titullohet “Vendim për korrigjimin e aktit të marrjes së tokës në pronësi” dhe hartohet në dy kopje origjinale, njëra nga të cilat, së bashku me dokumentacionin e krijuar, mbetet pranë komisionit vendor.

9. Komisioni vendor plotëson në katër kopje origjinale aktin e ri të marrjes së tokës në pronësi. Akti duhet të jetë në format A4, me ngjyrë të verdhë, shkruar me shkronja të zeza, sipas lidhjes nr.1, që i bashkëlidhet këtij vendimi. Akti i ri i marrjes së tokës në pronësi shoqërohet me planvendosjen e ngastrës/ngastrave, e cila duhet të jetë sipas lidhjes nr.2, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

10. Komisioni vendor dërgon në SAMT, në këshillin e qarkut, autorizimin dhe kopjen origjinale të vendimit të mësipërm, për lëshimin e aktit të ri të marrjes së tokës në pronësi, bashkë me fotokopje të dokumentacionit të ri ligjor, të plotë, të krijuar, si dhe katër aktet e marrjes së tokës në pronësi, së bashku me katër planvendosjet, të plotësuara nga ky komision. Autorizimi për lëshimin e aktit të ri të marrjes së tokës në pronësi ka përmbajtjen dhe formën, sipas lidhjes nr. 3, që i bashkëlidhet këtij vendimi.

11. SAMT-ja, në këshillin e qarkut, në bazë të këtij vendimi dhe të dokumentacionit, që disponon, kontrollon aktin e ri të marrjes së tokës në pronësi dhe planvendosjet përkatëse të ngastrës/ngastrave dhe kur i gjen ato në përputhje me kërkesat e ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i miraton.

Akti i ri i marrjes së tokës në pronësi dhe planvendosja numërtohen e nënshkruhen nga përgjegjësi i SAMT-së, dhe mbi nënshkrim vendoset vula e këshillit të qarkut.

12. SAMT-ja, brenda 5 ditëve, plotëson aktet e mësipërme, në katër kopje, nga të cilat, njëren e mban në arkiv, një tjetër ia përcjell, zyrtarisht, ZVRPP-së për regjistrim, dhe dy të tjerat ia përcjell komisionit vendor.

13. Komisioni vendor mban në arkiv një kopje të aktit të ri të marrjes së tokës në pronësi dhe një kopje ia dorëzon përfaqësuesit, i cili është pajisur me prokurë, nga bashkëpronarët.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

AKTI I MARRJES SË TOKËS NË PRONËSI

PREFEKTURA _____
 KOMUNA _____
 FSHATI _____
 ZONA KADASTRALE Nr. _____

Vendimi K.V. Nr. _____ Datë _____

Numri i Aktit nga S.A.M.T. _____

Në zbatim të ligjit nr 9948, datë 7.7.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore"

Familjes së _____

i jepet në pronësi toke gjithsej _____ m²

Nr. Vëndor	VENDODHJA E NGASTRËS		Sipërfaqja e tokës bujqësore në m ²				KUFIZIMET					
	Emërtimi i ngastres kadastral	Numri kadastral	Gjithësej	Nga kjo			VERI	LINDJE	JUG	PERËNDIM		
				Arë	Pemtores	Vreshtë					Ullishte	

KY AKT BËHET NË KATER KOPIJE, NJERA PREJ TË CILAVE I JEPET NË DORËZIM PRONARIT, NJERA S.A.M.T., NJERA Z.V.R.P.P. DHE TJETRA KOMISIONIT VENDOR.

PËR SAMT QARKUT
PERGJEGJESI

Emri, mbiemri _____
 Firma _____

VULA

PËR K.V.PREFEKTURËS
DREJTORI

Emri, mbiemri _____
 Firma _____

VULA

PLANVENDOSJA E PRONES

LIDHJA 2

Vendimi K.V. Nr. _____ Datë _____ Numri i Aktit nga S.A.M.T. _____

A. IDENTIFIKIMI I PASURISE:

ADRESA E PASURISE: PREFEKTURA _____ KOMUNA _____ FSHATI _____

ZONA KADASTRALE NR _____ INDEKSI I HARTES _____ SHKALLA _____ NR NGASTRËS _____

B. PERSHKRIMI I PASURISE: LLOJI I PASURISE _____ SIPËRFAQJA _____ MZ _____

KUPITARËT: VERI _____ JUG _____ LINDJE _____ PERËNDIM _____

C. FAMILJA E _____

SHENJA KONVENCIONALE:

PRONA SIPAS VENDIMIT
(TE NGJYROSUR)



PËRGATITI:

PËR : K. V. PREFEKTURA E QARKUT TIRANË

Emri,mbiemri _____

Firma _____



SAMT
PREFEKTURA E QARKUT TIRANË
PËRGJEGJSI

VULA

Emri,mbiemri _____


Firma _____

K. V. V.T.PRONËSISË
PREFEKTURA E QARKUT TIRANË
DREJTORI

VULA

Emri,mbiemri _____

Firma _____



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KESHILLI I MINISTRAVE**

**AKTI
I MARRJES
SË TOKËS
NË PRONËSI**



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKтура E QARKUT _____
KOMISIONI VENDOR I VLERESIMIT TE TITUJVE TE
PRONESISE

Nr. Prot. Date .2009

A U T O R I Z I M

Ne zbatim te nenit 8, paragrafi 4 te ligjit Nr. 9948, date 07.07.2008, «Per shqyrtimin e vlefshmerise ligjore te krijimit te titujve te pronesise mbi token bujqesore», pasi u vleresua kerkesa per korrigjimin e “Aktit te marrjes se tokes ne pronesi”, te leshuar nga komisioni i tokes i fshatit(subjektit) _____, te komunes/bashkise _____, ne favor te familjes bujqesore te _____ dhe dokumentacionit te ri ligjor te krijuar, Komisioni Vendor i Vleresimit te titujve te pronesise (KV) prane Prefektit te Qarkut _____ mori Vendimin Nr. _____, date _____ “Per korrigjimin e “Aktit te marrjes se tokes ne pronesi ne favor te familjes _____”. Mbi bazen e ketij vendimi, Komisioni Vendor ka plotesuar “Aktin e ri te marrjes se tokes ne pronesi” ne kater kopje origjinale.

Bashkelidhur ju dergojme nje kopje origjinale te Vendimit Nr. _____, date _____, te Komisionit Vendor, fotokopjen e dokumentacionit te ri ligjor te krijuar si dhe kater kopje origjinale te “Aktit te ri te marrjes se tokes ne pronesi” te plotesuara nga ne, per t’u kontrolluar, vleresuar dhe plotesuar per pjesen qe ju takon juve sipas pikes 9 te VKM nr. _____, date _____.

Per sa me sipër autorizohet Seksioni i Administrimit dhe Mbrojtjes se Tokes ne Keshillin e Qarkut _____, per leshimin e “Aktit te marrjes se tokes ne pronesi”, ne favor te familjes bujqesore te _____.

DREJTORI I K.V.

()

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 258 472 (Kryeredaktori).
Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

Hyri në shtyp më 24.3.2009
Doli nga shtypi më 25.3.2009

Tirazhi: 3300 copë	Formati: 61x86/8
--------------------	------------------

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2009

Çmimi 44 lekë